

1 E martë, 23 prill 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-
8 BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,
9 Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
10 Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si zakonisht
12 kemi një aspekt paraprak që duam të trajtojmë përpara se të
13 fillojmë.

14 Më 4 prill, në transkript në faqen 14398, rreshtat 17 dhe
15 në faqen 14400, rreshti 2, Trupi Gjykses kërkoi, foli lidhur
16 me mungesat e të akuzuarve në sallat e gjyqit dhe tha se duhet
17 komunikuar kjo 24 orë përpara se i akuzuari të mos jetë i
18 pranishëm.

19 Është informuar Trupi Gjykses se ky njoftim 24 orësh ka
20 pasoja të konsiderueshme logjistike dhe financiare. Kështu që
21 ne kërkojmë që kërkesa të tilla të dorëzohen 48 orë
22 paraprakisht.

23 Ju lutem atëherë të keni parasysh që të dorëzoni kërkesat
24 për mosprani në sallën e gjyqit 48 orë më përpara. Sigurisht,
25 në raste të jashtëzakonshme ne do të jemi të gatshëm që të

1 lejojmë edhe orare më të shkurtra, por rregullisht do të donim
2 që të na njoftoni 48 orë paraprakisht.

3 Keni gjë për të trajtuar në lidhje me këtë? Besoj se 48
4 është e arsyeshme? Duhet të keni parasysh që kjo është e
5 rëndësishme për planifikim.

6 Atëherë meqë nuk ka asnjë parashtrim në lidhje me këtë,
7 Trupi Gjykses ndryshon urdhrin që ka lëshuar më 4 prill dhe
8 urdhëron që lejet, kërkesat për mospraninë e të akuzuarve në
9 sallën e gjyqit, me përjashtim të rrethanave të
10 jashtëzakonshme, të komunikohen jo më pak se 48 orë përpara
11 seancës. Për shembull, kur një i akuzuar kërkon të mos jetë i
12 pranishëm në sallën e gjyqit ditën e hënë, atëherë kërkesa i
13 duhet dorëzuar Trupit Gjykses të enjten e javës pararendëse. E
14 kuptoj që kjo kërkon më shumë ditë por duhet të keni parasysh
15 që duhet organizuar transporti dhe kompania që organizon
16 transportin duhet të përfundojë të gjitha organizimet ditën e
17 premtë.

18 Së fundmi, Trupi Gjykses rikujton që kur të bëhen kërkesa
19 për mospraninë në sallën e gjyqit, ato duhet të kenë edhe një
20 arsyetim lidhur me këtë kërkesë. Përndryshe Trupi Gjykses nuk
21 do t'i lejojë kërkesa të tilla.

22 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Sa i takon pjesëve të librit të
24 Jakup Krasniqi "Kthesa e Madhe", dua t'ju informoj që ZPS-ja
25 kërkon që fjalët që u kërkuan të pranoheshin dhe t'i shtohen

1 provës materiale P189 dhe ne e kemi bërë kërkesën përmes
2 parashtrimit të protokolluar 01596, meqë është tashmë një
3 pjesë e pranuar e këtyre provave materiale.

4 Sekretari i Gjykatës, na njoftoi, në fakt, se prova
5 materiale P729 ka tre faqe që lidhen me seksionin e zonës së
6 Pashtrikut. Sidoqoftë, një prej këtyre faqeve ka redaktime në
7 fund dhe nuk përmban pjesë të librit të cilat unë ia paraqita
8 dje dëshmitarit. Prandaj unë ju bëj edhe një herë kërkesën që
9 faqet që unë kërkoj të pranohen në provat gjyqësore me numër
10 U0015-8849 deri në 8853 për pjesën e zonës së Pashtrikut,
11 bashkë me materialin U0015-8869 deri në 873 që lidhen me
12 seksionin e Nerodimës t'i shtohen provës materiale, që unë
13 citova më herët. Pra, konkretisht prova materiale P189, sepse
14 ajo mban të gjitha faqet që lidhen me faqet që i paraqita unë
15 dje dëshmitarit dhe mendoj që është më mirë që të jem në këtë
16 provë materiale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do
18 t'i kërkoj Sekretarit të Gjykatës të më thotë nëse është e
19 mundshme që të bëhet kjo.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë. Do të jemi në
23 seancë publike. Do të bëjmë një pushim të shkurtër në orën
24 10.00. Dhjetë minuta pushim.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se
2 erdhët, Dëshmitar.

3 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
5 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju rikujtoj që t'ju përgjigjeni
6 pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një
7 pyetje lirisht kërkoni që të përsëritet ose thoni që nuk e
8 kuptoni në mënyrë që ta sqarojnë.

9 Gjithashtu, mos harroni të na thoni ku bazoni njohurinë
10 tuaj lidhur me faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë
11 pyetje.

12 Ju kujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën
13 sikurse vetë e keni lexuar përmes deklaratës solemne. Flisni
14 pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se të
15 përgjigjeni dhe ju lutem flisni ngadalë në mënyrë që t'ju
16 ndjekin edhe përkthyesit.

17 Nëse në ndonjë moment keni nevojë për pushim, na vini në
18 dijeni.

19 Do të vazhdojmë tani me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

20 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

22 DËSHMITARI: RAMIZ QERIQI [Vijon]

23 Pyetje nga znj. D'Ascoli: [Vazhdim]

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

25 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

1 PË. Mirëmëngjesi.

2 PY. Përpara se të vazhdoj me pyetjet ka një datë që ka dalë
3 në transkriptin e ditës së djeshme që do të doja ta diskutonim
4 pak.

5 Dokumenti i fundit që ne diskutuam ishte një leje
6 udhëtimi që e kishte nënshkruar komandant Sokoli. Shukri Buja.
7 Ju kujtohet?

8 PË. Po.

9 PY. Ky dokument është pranuar tashmë në provat gjyqësore dhe
10 mban numrin P1120. Sa i takon datës apo periudhës së këtij
11 dokumenti, ju bëra pyetjen se kur është lëshuar ky dokument
12 dhe ju thatë kjo është lëshuar diku në maj.

13 Për sqarim, e kishit fjalën për majin e 1998?

14 PË. Po.

15 PY. Në rregull. Thjesht doja ta thoja këtë në mënyrë që dhe
16 viti të zbardhet në procesverbal.

17 Dëshmitar, do t'ju tregoj një leje tjetër udhëtimi.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Lutem që të shfaqet në ekran
19 materiali me ERN IT-03-66 P171 dhe prova materiale P171-A. Ju
20 lutem që të shfaqen përbri njëra-tjetrës në ekran.

21 PY. E shihni dokumentin në kompjuter, z. Qeriqi?

22 PË. Po.

23 PY. Këtë dokument ta treguam javën e kaluar gjatë seancës
24 përgatitore dhe ju thatë se nuk e kishit parë këtë dokument më
25 përpara, kështu?

1 PË. S'e kam parë. Ashtu është.

2 PY. Por ju e dinit që lëshoheshin leje udhëtime në 1998,
3 sepse ju vetë i keni dhënë një kopje leje udhëtimi ZPS-së nga
4 batalioni juaj, apo jo?

5 PË. Po, ashtu. Ka qenë nga Batalioni 3 dikund.

6 PY. Në rregull. Këtu thuhet:

7 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës Njësiti 'Çeliku'"

8 Data është 8 korrik 1998 dhe është nënshkruar nga
9 komandant Tigri dhe është nënshkrimi përkatës. Dokumenti jep
10 leje të udhëtohet në magjistralen Kleçkë dhe kthimin, dhe
11 anasjelltas. Diçka nuk lexohet në fakt në anglisht, nuk është
12 zbardhur tek anglishtja këtu.

13 Sa i takon njësitet Çeliku, ju thatë se ky njësit ishte
14 nën komandën e Fatmir Limaj, komandant Çelikut? Dhe kjo është
15 për referencë në materialin P1114.1, në faqen 3572. Kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Po emri apo nofka Tigri, ju thotë gjë, e njihni?

18 PË. Po. E kam njoft po. Skënder Hoxha. Më fal. Skënder Hoti.

19 PY. Ka qenë komandant?

20 PË. Komandant i batalionit të tretë, të katërt, më falni, të
21 katërt, batalionit të katërt.

22 PY. Po. Kjo është dhe në dëshminë tuaj. Që ka qenë komandant
23 i batalionit të katërt. Dhe ju shënuat edhe zonat e
24 përgjegjësisë që kishin katër batalionet e Brigadës 121, i
25 shënuat në hartë ju këto dhe kjo hartë tani është e pranuar si

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 7

1 prova materiale P1116.

2 Tani nëse e sheh dokumentin je në gjendje ta lexosh
3 origjinalin dhe të shihni emrin në rreshtin e dytë ku thotë
4 "Relacionin". Jeni në gjendje ta lexoni cili është vendi këtu?
5 PË. Po ju e lexuat më herët.

6 PY. Po e kisha fjalën që para Kleçkës, para Kleçkës është një
7 fjalë tjetër. E lexoni dot në shqip cila fjalë është kjo?

8 PË. Nuk jam i saktë. Për Kleçkë edhe e shof që a në Kleçkë po
9 kjo --

10 PY. Po, është shumë e vështirë që të lexohet shkrimi i dorës.
11 Në rregull. Nuk ka problem. A mund të na thoni ku ishte baza e
12 Çelikut? Ku ka qenë baza Çeliku? Është tek rreshti i fundit në
13 krah të datës dhe nënshkrimit. Baza Çeliku ku ishte, ku
14 ndodhej?

15 PË. Në Kleçkë. Në Kleçkë. Në Kleçkë.

16 PY. Ky dokument që mban numrin e provës materiale P1115.2,
17 faqja 35, 37, a përputhet kjo me dëshminë tuaj që ushtarëve,
18 për shembull, u nevojitej leje që të udhëtonin, për shembull,
19 të shkonin nga zona e Batalionit 4 në zonën e një batalioni
20 tjetër?

21 PË. Po.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja
23 kërkon që ky dokument të pranohet në provat gjyqësore me
24 klasifikimin publik.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë për faktin se
2 dëshmitari nuk e ka parë ndonjëherë më përpara këtë dokument.
3 As nuk ka folur për autenticitetin e dokumentit. Edhe fakti që
4 i kanë bërë disa pyetje dhe i kanë thënë dëshmitarit të lexojë
5 pjesë të caktuara në këtë provë materiale, në këtë material,
6 nuk nënkupton që ky dokument është autentik.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
8 dokumenti dhe merr numrin e provës materiale në bazë të
9 rregullës 138.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali me ERN IT-03-
11 66 171 merr numrin e provës materiale P11121. Ju faleminderit.

12 Ju thatë me klasifikimin publik?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, me klasifikimin publik.

14 PY. Dëshmitar, po flisnim për njësitin Çeliku dhe nga
15 deklarata juaj, ju keni thënë që Isak Musliu ka qenë pjesë e
16 këtyre njësiteve nën komandën e Fatmir Limajt. Ju dhe Isak
17 Musliu jeni bërë shok në Gjermani dhe keni udhëtuar bashkë
18 drejt Kosovës, apo jo? Kjo është në deklaratën tuaj.

19 PË. Po. Po.

20 PY. Gjithashtu keni dëshmuar se Isak Musliu, nofkën Qerqizi,
21 pra, kjo është e reflektuar në dokument, keni thënë që atij ju
22 vu kjo nofkë sepse kishte mjekër edhe mori emrin e luftëtarit
23 shqiptar Çerçiz Topulli, kështu?

24 PË. Po.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do lutesha të shfaqej në ekran

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 9

1 materiali me ERN IT-03-66 P23, P23.A. Ju lutem që të shfaqen
2 përbri njëri-tjetrit. Mund të nxirrni fillimisht faqen e parë.
3 PY. Dëshmitar, do t'ju tregoj tani një bllok shënimesh që ua
4 kemi treguar dhe gjatë seancës përgatitore javën e kaluar. Do
5 lutesha që të shkonim në faqen tjetër në shqip. Besoj se ju
6 keni thënë që nuk e keni njohur shkrimin e dorës, kështu?
7 PË. Ashtu është, po.

8 PY. Dhe komentuat lidhur me disa pjesë të këtij blloku ku
9 përmendet emri juaj dhe këtu përshkruhen ngjarjet që lidhen
10 dhe me ju.

11 Kjo ka qenë një provë materiale e Prokurorisë në ish-
12 Tribunalin e Hagës, ku ka qenë i bashkakuzuar dhe Isak Musliu
13 në atë çështje gjyqësore.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem shkojmë në faqen 11 të
15 dokument origjinal që mban numrin U003-2630 dhe faqen 4 të
16 përkthimit në gjuhën angleze.

17 PY. Dëshmitar, ju e shihni në ekran një pjesë të këtij
18 blloku, titulli thotë: "Ditari i vonuar". E kuptoj që është e
19 vështirë të lexohet shkrimi i dorës. Po do ju lutesha që ta
20 ndiqni, nëse mundeni, në origjinal ndërkohë që unë do të lexoj
21 anglishten dhe do të përkthehet me gojë në mënyrë që ta
22 kuptoni më lehtë.

23 Do të lexoj faqen 4 të anglishtes.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Gjykatës
25 të shohim pjesën e plotë të paragrafit që lexon "Ditari i

1 vonuar".

2 PY. Dëshmitar, ju lutem dëgjoni pjesën që do të lexoj sepse
3 do të kem disa pyetje për ju.

4 "Pas futjes nga toka shqiptare në territorin e Kosovës,
5 dikun pranë kodrave të Konjushës, të fshatit Konjushë, tre
6 anëtarë të UÇK-së erdhën të merrnin nën përgjegjësinë e tyre.
7 Një person me nofkën Hoxha po na udhëhiqte udhën drejt
8 Drenicës. U kthyem /nuk lexohet/ lart /nuk lexohet/ në të
9 djathtë dhe në mbrëmje zbritëm për poshtë kodrës dhe shkuam në
10 urën e Drinit. Vijuam drejt rrugës së asfaltuar që të çonte
11 drejt /?Çamdanicës/. Pasi kaluam një /nuk lexohet fjala nga
12 shqipja/ ku ishte një punkt policore serbe direkt pas /prapë
13 nuk lexohet/ vazhduam udhëtimin dhe arritëm pranë në
14 punëtorie, punishteje pra, ku /nuk lexohet/ po punonin.
15 Kërkuam ushqim dhe pimë ujë. Më pas i kërkuam pronarit të na
16 ndihmonte me një mjet transporti. Morëm /nuk lexohet/ drejt
17 Kostovës dhe vazhduam drejt Kolishanit. Po shkonim në drejtim
18 të Likovcit. Pranë një /?stacioni/ mbi /?urën e Drinit/, Afeti
19 ndrydhi këmbën dhe na u desh ta çonim te një doktor kur
20 mbërritëm në Likovc."

21 PY. Po, e saktë. Më kujtohet.

22 PY. Çfarë doni të thoni më kujtohet?

23 PË. Ky e paska bë përshkrimin e rrugës nga kemi shku për
24 Likovc. Më kujtohet për Afetin që e ka pas lëndu këmbën dhe që
25 u shëru. Aty ka qenë një shtëpi ku kanë qenë mjekët edhe është

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 11

1 shëru aty.

2 PY. Pra, që ta përmbledhë, a pasqyrohet vërtetë udhëtimi juaj
3 drejt Likovcit këtu --

4 PË. Po.

5 PY. -- pasi hytë në Kosovë nga Shqipëria?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe na keni thënë sa ka ndodhur në fund të marsit fillimi
8 i prillit 1998, kështu?

9 PË. Ashtu.

10 PY. Nëse më kujtohet saktë, ju keni thënë se një person me
11 emrin Hoxha ju shoqëroi, kështu?

12 PË. Po. Ju lutem me pseudonimin Hoxha, jo mbiemrin.

13 Pseudonimin Hoxha.

14 PY. Po. Po, patjetër.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër për
16 anglishten, ndërsa shqipja është në të njëjtën faqe.

17 PY. "Doktori ia vendosi, Afetit, pra, këmbën në allçi. Deri
18 në atë momente ne e thërrisnim me nofkën Kastrioti, po nga ai
19 moment shokët e luftës ia ndryshuan emrin dhe filluan ta
20 thërrisnin me nofkën 'Çopo' "

21 PË. E saktë.

22 PY. Pra, a përputhet dhe kjo pjesë me kujtesën tuaj dhe me
23 mënyrën sesi kanë vijuar ngjarjet atëherë, se janë zhvilluar
24 ngjarjet që ia ndryshuan nofkën Afetit?

25 PË. Po.

1 PY. A ju kujtohet si e ka pas emrin dhe mbiemrin Afeti të
2 plotë?

3 PË. Afet Bilali.

4 PY. Në rregull.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër të
6 dokumentit origjinal, 12, me ERN U003-2631. Ndërsa në anglisht
7 do vazhdojmë tek faqja numër 5.

8 PY. "Të nesërmen, dolëm në terren dhe filluam menjëherë
9 stërvitjet psikologjike-fizike dhe taktike. Pak ditë më pas
10 rreth tri a katër ditë më pas, unë vetë dhe Ramizi ndryshe
11 'Luani' morëm detyrat në zonën e Silakut dhe të Shtimes ..."

12 Dhe më pas është diçka që nuk është pasqyruar dot në
13 anglisht.

14 "Atë mbrëmje i ashtuquajturi 'komandant Çeliku', Fatmir
15 Limaj, erdhi të na merrte. Bashkë me 'Çelikun' ne shkuan në
16 Kleçkë ku takuam gjashtë a shtatë të rinj me maska që ishin
17 pjesëtarë të UÇK-së. Ata na përshëndetën dhe kur morën vesh se
18 kush ishim hoqën maskat dhe e vazhduan udhëtimin me ne".

19 Po kjo pjesë përputhet me kujtesën tuaj lidhur me atë
20 ngjarje?

21 PË. Përputhet se e kemi këtë udhëtim e kemi bë bashkë, ashtu
22 qysh është. S'më kujtohet për këta që i kena taku, mirëpo
23 udhëtimi ashtu është me Fatmirin e kemi bë atë udhëtim.

24 PY. Kush ka qenë --

25 PË. Fatmir Limaj.

1 PY. -- me ju tjetër gjithashtu?

2 PË. Ka qenë edhe një ushtar, tash është dëshmor me sa di,
3 Sadik Shala ka qenë me Fatmir Limën.

4 PY. Këtu përshkruhet udhëtimi që keni bërë me Fatmir Limaj
5 dhe Isak Musliun?

6 PË. Po.

7 PY. Do t'ju lexoj disa rreshta të tjerë në mes të faqes:

8 "Hymë dhe atje për herë të parë takova komandant Ismet
9 Jasharin, ndryshe 'Kumanova'. Ai ishte /nuk lexohet fjala/
10 sepse ishte plagosur në të dyja këmbët."

11 A ju kujtohet në atë udhëtim të keni takuar Ismet
12 Jasharin?

13 PË. Po, më kujtohet se ka qenë një këmbë i plagos, të dyja
14 s'më kujtohet, po i plagos ka qenë.

15 PY. Po i heq, po kaloj disa rreshta dhe po lexoj disa rreshta
16 nga fundi i faqes.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për origjinalin duhet të
18 kalojmë në faqen tjetër, në faqen 13.

19 PY. Në anglisht do të vazhdoj:

20 "Një ose dy ditë më pas, unë dhe komandant Luani, Ramiz
21 Qiriqi, morëm detyrat në fshatin e komunës së Shtimjes. Është
22 dhe rasti kur shkova për herë të parë në shtëpi pas dy vitesh.
23 Duhet thënë fakti se kur u takuam me Ismet Jasharin ai m'u
24 drejtua me këto fjalë: 'Kjo nofkë' /nuk lexohet/, me të cilën,
25 siç më thërrasin shokët për dy vjet dhe që ma ka dhënë Luani,

1 'nuk është për ju'. 'Urime për nofkën tuaj të re, Qerqiz,
2 sepse në fakt ngjan me Qerqiz Topullin sidoqoftë'. Unë
3 buzëqesha dhe i thashë 'Faleminderit. Unë e mbaj këtë nofkë po
4 kam frikë se është shumë i madh ... për mua ky emër'!"

5 Dëshmitar, përputhet kjo me kujtesën tuaj sesi e ka marrë

6 --

7 PË. Po.

8 PY. -- sesi ia vunë Isak Muliut nofkën Qerqizi?

9 PË. Po. Ka qenë propozim i Ismet Jasharit. Ndërsa unë nuk e
10 kam ndëgju që ka thënë -- fjalë tjera s'i kam dëgju. S'më
11 kujtohen, mirëpo më kujtohet që Ismeti ia ka dhënë këtë
12 propozim që ta ketë pseudonimin Qerqizi. Ismet Jashari.

13 PY. Do lexoj pjesën ku thotë: "U larguam nga Kleçka ..."

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po duhet të kalojmë në faqen
15 tjetër te anglishtja

16 PY. "Në fshatin Guncat në mbrëmje mbërritëm në shtëpinë e
17 Feratit. Ishte kunati i Luanit. Na pritën ... mirë. Një natë
18 më pas deshëm të futeshim në qafën e Duhlës në drejtim të
19 fshatit Grejcefc. Arritëm në fshatin Bllacë dhe qëndruam disa
20 orë tek kunati i Feratit. Kur deshëm të iknim për Duhlë, sapo
21 dolëm në oborr filluan të shtënat nga armë të ndryshme. Vinin
22 nga drejtimi i Duhlës. Nuk e dinim çfarë të bënim sepse nuk e
23 kishim idenë kush po shtinte dhe nuk po dinim çfarë po
24 ndodhte. Dhe vendosëm që të shkonim në shtëpinë e Luanit".

25 Edhe një herë Dëshmitar, a përputhet kjo me kujtesën

1 tuaj?

2 PË. Ky është fshati Duhël, ku thotë që ka pas të shtëna.

3 Duhël. Ndërsa ky fshati ku kemi nejt Ngucat aty te Ferati

4 është domethënë, motrën e kam pas aty. Ai dhëndër është. Tash

5 s'di si e quani ju, që duhet me thënë, po dhëndër i jem, te

6 motra kemi qenë. Ndërsa këtu ku është janë bë gjuajtjet ka

7 qenë fshati Duhel. Pastaj normal kemi udhëtu te deri në

8 Krojmir në fshat timin, në shtëpinë time ku kam lind. Ashtu

9 është.

10 PY. Si e kishte mbiemrin Ferati?

11 PË. Ferat Shala.

12 PY. A kishte ndonjë pozitë në UÇK në atë kohë?

13 PË. Jo.

14 PY. Po çfarë ndodhi pastaj pasi vendosët të shkonit në

15 shtëpinë tuaj?

16 PË. Me shku në shtëpi teme, pastaj kemi shku të Isakut,

17 kështu siç e ka shkru ky.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe t'i kthehemi faqes së parë

19 në anglisht dhe treshit në origjinal që ka numrin U003-232.

20 PY. Dëshmitar, në këtë faqe shihni dy shënime që kanë datë të

21 caktuar. E para ka 27 shkurt 1999, e dyta 5 mars 1999.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të zbresim më poshtë në faqen e

23 origjinalit dhe po kështu dhe të anglishtes.

24 PY. Dëshmitar, shikoni dy rreshtat e fundit ju lutem në

25 variantin në shqip. Dy rreshtat e fundit.

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 16

1 PË. S'un e lexoj mirë këtë. Qe.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër të
3 origjinalit. Zbresim poshtë.

4 DËSHMITARI: Shkruan këtu diçka lidhur brigada, baza edhe
5 nuk, s'un e lexoj. Brigada, s'po di.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

7 PY. Ajo që desha të lexoja ishte pjesa ku duket emri Qerqiz
8 dhe desha të konfirmoja që këtu vazhdon të flitet për Isak
9 Musliun?

10 PË. Po, normal.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Avokates që të
12 tregojë se ku në variantin anglisht duket fjala Qerqiz?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në faqen 1 në anglisht. Ja në
14 krye të faqes, pak më lartë. Të zbresim pak më poshtë. Mbase
15 në faqen tjetër. Nuk po e gjej kollaj. Në faqen 2 të
16 anglishtes, rreshti në fund të paragrafit të parë ku thuhet,
17 ku del fjala Qerqiz dy herë, në rreshtin 5 dhe 8, ku thuhet:

18 "Për sa më takon mua, Qerqiz, kjo nuk është normale".

19 Kjo është në faqen e pestë të origjinalit, U003-2624. Në
20 fund të kësaj faqeje. Deri në fund.

21 PY. Dëshmitar, po të shikoni orarin që është në majtë aty
22 është ora e shkruar 7.30 apo 19.30, e shihni emrin e Qerqizit
23 aty? Në anglisht thuhet:

24 "Për mue, Qerqizin, kjo abnormale".

25 Është rreshti i fundit. Doja thjesht të konfirmonit që

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 17

1 Qerqizi këtu është Isak Musliu.

2 PË. Ky këtu, po. Ky këtu i parafundit, rreshti i parafundit?

3 Po. Po këtu --

4 PY. Po, po aty.

5 PË. -- është koha, është mirë me gjet këtu kohën për kur ka

6 shkru këtu, se ka të bëjë këtu lart shkrun "Ferri" lart [E

7 pakuptueshme] dhe kjo është Qerqizi, normal që është Qerqizi.

8 PY. Në të majtë janë oraret. Mjafton.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këtë ditar
10 ne e paraqesim për pranim si provë materiale publike.

11 Po.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Kemi kundërshtime jo vetëm për këtë
13 ditar por për të gjitha faqet e tjera që kanë të bëjnë me një
14 periudhë të ndryshme kohore të shkurtit dhe qershorit 1999,
15 periudhë për të cilën këtij dëshmitari nuk i është kërkuar që
16 të komentohet, me përjashtim të faktit që i është kërkuar që
17 të gjegjë një fjalë në njërën prej faqes. Prokuroria nuk mund
18 të paraqesë faqe të tëra të vitit 1999 që i përkasin një
19 periudhe të ndryshme kohore.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe ne jemi i të njëjtit mendim.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po. Edhe ne kemi të njëjtin
22 mendim, nuk mund të paraqitej gjithë dokumenti vetëm për shkak
23 se dëshmitari ka pranuar një pjesë. Vetëm kjo pjesë që ka
24 konfirmuar mund të pranohet si provë materiale jo e tëra.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë i bashkohem këtij

1 mocioni.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, janë 9
3 faqet në anglisht. Ditari është i mbushur me faqe të zbraza,
4 bosh dhe katër nga këto faqe janë relevante dhe janë të
5 lidhura me dëshmitarin dhe kjo mjafton.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përse kemi
7 nevojë për faqet e tjera të cilat nuk janë përmendur?

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Janë relevante, të nderuar
9 Gjykatës. Po të dëshironi mund të paraqes se përse pjesa
10 tjetër e këtij ditari, vlerësimi dhe pesha që do të jepet mund
11 të shikohen gjatë kundërpvetjeve të Palës Mbrojtëse dhe në
12 fund vlerësimin që bëhet në gjykim, por ato janë relevante për
13 sa i përket argumenteve të Prokurorisë. Duke qenë se
14 dëshmitari ka paraqitur kontekstin dhe i ka komentuar mbi disa
15 pjesë të shumta të këtij, ne mendojmë që i përmbushim të
16 gjitha kriteret e pranueshmërisë si provë materiale.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si janë
19 relevante faqet e tjera? Si lidhen me aktakuzën e kësaj
20 çështjeje gjyqësore?

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në faqen 1, për shembull, ka
22 informacion që ka të bëjë me zonën operative të Nerodimës. Në
23 faqen 3, ka të bëjë me funksionimin e policisë ushtarake edhe
24 për sa i përket rregulla të procedurës së UÇK-së. Pjesët e
25 tjera mbështesin dëshminë e dëshmitarit. Në faqen 6 bëhet

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 19

1 fjalë për task-forcën edhe urdhrin që jep Shtabi i
2 Përgjithshëm ushtarëve që të mos lëvizin. Në faqet e tjera
3 bëhet fjalë për aktivitetet e policisë ushtarake në zonën e
4 Nerodimës në vitin 1999.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
6 po.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kjo është arsyeja se përse kjo
8 është qasje e gabuar. Po shfrytëzohet një dëshmitar i cili
9 mund të tregojë që një pjesë e dokumentit është i saktë për të
10 trafikuar si të thuash pjesën tjetër të këtij dokumenti mbi të
11 cilin Prokuroria don të mbështetet për pjesët e tjera të
12 argumenteve të saj.

13 Ky është shqetësimi që kemi identifikuar gjatë gjithë
14 kohës ne. Pavarësisht se në këtë rast, Prokuroria ka treguar
15 haptazi se përse ky dëshmitar po shfrytëzohet si një kal Troje
16 si të thuash në këtë drejtim.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Do t'i shënojmë për identifikim këto dokumente.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] 03-266 P33 do të
21 shënohet për identifikim P1122.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryetar i Gjykatës, a
24 mund të shtoj një gjë?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Qëndrimi i Prokurorisë është që ne
2 mund të bëjmë pyetje gjatë radhës që do të kemi. Por, fakti
3 është që këtu bëhet fjalë me zonën e Nerodimës që për të cilën
4 nuk flet ky dëshmitar. Ky ka qenë jashtë Kosovës në këtë
5 periudhë kohore. Dhe flet për Shtabin e Përgjithshëm, për të
6 cilin ky dëshmitar nuk ka dijeni. Se dhe nuk di sesi mund të
7 shfrytëzojmë këto faqe gjatë kundërpvetjeve tona.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, nuk
9 mund eksplorohen vetëm me këtë dëshmitar këto faqe. E dimë që
10 ky dëshmitar nuk ka qenë në Kosovë në vitin 1999 dhe atij i
11 janë paraqitur ato pjesë të ditarit për të cilat ai mund të
12 japë dëshmi.

13 Ndërsa për sa i përket pjesës tjetër të këtij dokumenti,
14 janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë dhe, sa i përket
15 periudhës së 1998, ato do të vendosen sesa peshë do të kenë
16 ato në kohën e duhur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim
18 vendimin tonë në momentin e duhur. A keni pyetje të tjera?

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po.

20 PY. Dëshmitar, do të kalojmë tani në një temë tjetër.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran P8
22 në të dy gjuhët.

23 PY. Dëshmitar, ky dokument që do të shfaqet në ekran është
24 rregullorja e brendshme e UÇK-së që rregullonte jetën në vitin
25 1998. I kemi diskutuar të dyja gjatë edhe gjatë dëshmisë suaj

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 21

1 për Tribunalin e Hagës dhe intervistën e ZPS-së. Ju thatë që i
2 keni marrë këto dokumente në vitin 1998 dhe ia keni dërguar
3 ushtarëve tuaj. Kjo është në pjesën P1114.1, faqja 303064. A
4 ju kujtohet një gjë e tillë?

5 PË. Po.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen 15
7 në të dy gjuhët.

8 PY. Dëshmitar, do të dëshiroja që t'i hidhnit një sy
9 kapitullit 8 ku flitet për policinë ushtarake dhe detyrat e
10 saj. E shohim në anglishte. Mund të shikojmë pjesën në gjuhën
11 shqipe.

12 Në deklaratat tuaja, ju keni diskutuar lidhur me policinë
13 ushtarake, rolin e saj, për shembull, P114, 43611, keni folur
14 për detyrat e policisë ushtarake ku keni thënë që detyra e
15 tyre ishte të kujdeseshin për ushtarët, të kontrollonin për
16 sjelljen e tyre, sjellja e tyre për sa i përket popullatës
17 civile e kështu me radhë.

18 Më pas në intervistën tuaj, P1145, faqja 39, rreshti 40,
19 keni thënë që kontrolloheshin lejet e udhëtimit, lëvizjet e
20 njerëzve, arrestimet edhe i dërgonin ushtarët në drejtim të
21 brigadës. A të kujtohet që ke thënë një gjë të tillë në
22 dëshminë tënde?

23 PË. Po.

24 PY. Duke qenë që ky dokument është i njohur për ty dhe e keni
25 shpërndarë, unë nuk do t'i diskutoj të gjitha detyrat të cilat

1 paraqiten të renditura këtu. Por doja të shikoja që këto
2 dispozita që kanë të bëjnë me policinë ushtarake pasqyrojnë
3 mënyrën sesi ka funksionuar kjo polici ushtarake gjatë kohës
4 që ju keni shërbyer si komandant batalioni i Brigadës 121?
5 PË. Policia ka qenë një njësit i policisë te na një skuadër e
6 cila ka jetu në, domethënë, është ushqy në batalion. Mirëpo
7 është -- komandën e ka pas në brigadë, si të them, ka raportu
8 në brigadë. Ka marrë --

9 PY. Kjo ishte pyetja tjetër që desha të bëja. Por fillimisht
10 të pyeta nëse këto dispozita pasqyrojnë dëshmie tënde lidhur
11 me mënyrën sesi ka funksionuar policia ushtarake gjatë kohës
12 që ti ke qenë komandant batalioni në Brigadë 121. A mund t'i
13 përgjigjesh kësaj pyetjeje fillimisht dhe më pas do bëjmë
14 pyetje të tjera.

15 PË. Si, si ka funksionu? E thashë nëse --

16 PY. Jo, jo. Pyetja ime ishte: Këto rregulla a pasqyrojnë
17 dëshminë tënde për sa i përket funksionimit të policisë
18 ushtarake?

19 PË. Po, po. Po.

20 PY. Ju thatë që në batalionin tuaj ka patur njësit të
21 policisë ushtarake, kështu është?

22 PË. Po.

23 PY. Sa ishte numri i tyre dhe kur kanë ardhur për herë të
24 parë?

25 PË. Në fillim kanë qenë katër, pastaj janë ba shtatë. Deri në

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 23

1 shtatë ka shku. Që nga fillimi domethënë. Që nga maji,

2 domethënë, fillimi i majit ka --

3 PY. Viti?

4 PË. 1998. Jemi gjithnjë --

5 PY. A mund të tregosh gjithmonë për cilin vit bëhet fjalë?

6 PË. 1998.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të dy po
8 flisni në të njëjtën kohë. Prisni që të bëhet pyetja tjetër
9 dhe ti Prokurorja prisni që të japë përgjigjen përpara se të
10 bëni pyetjen tjetër.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

12 PY. Pra, thamë që periudha ishte nga maji i 1998. Ku ishin të
13 vendosur ata?

14 PË. Në Krojmir.

15 PY. A kishte një komandant të skuadrës së policisë ushtarake
16 në batalionin tuaj?

17 PË. Po. Në fillim ka qenë Ajet Hasani. Dëshmor është.

18 Zëvendës i tij ka qenë Ajvaz Korpuzi.

19 PY. A mund ta përsërisni emrin e personit i cili ka
20 zëvendësuar më pas Ajet Hasanin?

21 PË. Edhe një herë më fal, kjo mundet me qenë maj, fillimi i
22 qershorit dhe më aty kur kanë ekzistuar këta, ose fundi i majit,
23 fillimi i qershorit. Ajvaz Korpuzi ka qenë zëvendës i Ajetës.

24 Ndërsa kanë fillu me funksionu fundi i majit, fillimi i
25 qershorit.

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 24

1 PY. Pra, emri ishte Ajvaz Korpuzi?

2 PË. Po.

3 PY. Jo, Garfuzi siç paraqitet në transkriptin këtu?

4 PË. Korpuzi.

5 PY. Këtë dy ushtarë, Ajet Hasani dhe Ajvaz Korpuzi janë pjesë

6 e listës së dokumentit, të listës së anëtarëve të batalionit

7 tënd që i ke dhënë ZPS-së? Pra, P1116, faqe 6 deri në 19?

8 PË. Po.

9 PY. Në verën e vitit 1998 dhe deri kur u caktua komandanti i

10 brigadës, Haxhi Shala ka qenë komandant i policisë ushtarake

11 në nivelin e brigadës, kështu është?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe na thatë dhe kjo gjendet në 11157, faqja 23, që nofka

14 e tij ishte Topi, kështu është?

15 PË. Po.

16 PY. Dua të tregoj një dokument.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të vendosim dokumentin

18 U001-9725 deri në U001-9732 dhe variantin në anglishte ju

19 lutem që të mos transmetohet ky dokument publikisht.

20 PY. Dëshmitar, mund të qëndrojmë në faqen e parë, ndërkohë që

21 vendoset varianti në anglisht. Në fund shihni, pavarësisht se

22 nuk lexohet qartë. Aty ku thuhet:

23 "Sadik Shala - Batalioni Burgia ..."

24 PË. Burgia.

25 PY. Cili batalion është ky?

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 25

1 PË. Batalioni i tretë.

2 PË. I Brigadës 121, apo jo?

3 PË. Po.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër në të
5 dy gjuhët që kanë shenjën U001-726. Që është një shënim i 12
6 gushtit 1998. A mund ta zvogëlojmë me qëllim që të shihet e
7 gjithë faqja në shqipe, përfshirë edhe ajo pjesë ku është
8 nënshkrimi.

9 PY. A e dalloni se kush e ka nënshkruar këtë në fund të këtij
10 dokumenti?

11 PË. Po. Topi.

12 PY. Kush ishte Topi?

13 PË. Haxhi Shala. Komandanti i policisë Haxhi Shala.

14 PY. A ka qenë e zakonshme në atë kohë që të ekzistonin
15 shënime të tilla të shkruara me shkrim në të cilat
16 pasqyroheshin takime që janë mbajtur?

17 PË. Normale. Po.

18 PY. A e ke bërë dhe ti një gjë të tillë?

19 PË. Po.

20 PY. Këtu paraqiten rregullat e policisë ushtarake për
21 Batalionin Sadik Shala, Batalionin e Tretë të Brigadës 121.
22 Mund t'i hidhni një sy kësaj liste të rregullave. Unë mund të
23 lexoj nja dy, për shembull, ku thuhet:

24 "Policia ushtarake ka të drejtën ... në situatë të
25 caktuar, që të ekzekutojë, arrestojë edhe komandantë të

1 batalioneve në rast të dhunimit të rregullave".

2 Ju e keni dhënë këtë dëshmi tashmë dhe e konfirmoni një
3 gjë të tillë, apo jo?

4 PË. Po. Ashtu kanë thënë atëherë në atë kohë.

5 PY. "Ushtarët pa leje qarkullimi do të çarmatosen".

6 PË. Po, ashtu ishte.

7 PY. "Për arrestimin e civilëve duhet leje nga policia".

8 PË. Ka qenë detyrë e tyre ajo, jo e jona.

9 PY. Nuk do të lexoj të tërë këtë listë, po a janë këto
10 rregullat të cilat pasqyrojnë mënyrën sesi ka funksionuar
11 policia ushtarake gjatë kohës që ti ke shërbyer si komandant
12 batalioni në kuadrin e Brigadës 121?

13 PË. Po.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë ju lutem në faqen 5 në
15 të dy gjuhët.

16 PY. Dëshmitar, dua të bëjë disa pyetje për dy shënimet e
17 para. Të datës 15 gusht 1998.

18 Në të parën thuhet:

19 "Sot është vendosur të bisedohet me ushtarët e Kompanisë
20 së Racës, për t'i informuar lidhur me rregullat e policisë
21 ushtarake".

22 Ndërsa e dyta thuhet:

23 "Sot është biseduar me ushtarët që janë të vendosur tek
24 shtëpia e pylltarëve dhe janë lexuar rregullat e policisë
25 ushtarake".

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë në faqen 7 në të dy
2 gjuhët.

3 PY. Pas së cilës do të bëj pyetje lidhur me këto shënime pasi
4 janë të ngjashëm për nga përmbajtja e tyre.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe tani e kam fjalën për
6 shënimin e 19 gushtit, kështu që ta ngremë pak faqen në gjuhën
7 shqipe.

8 PY. Është një raport, raport i të mërkurës dhe thuhet që:

9 "Sot ishim në terren ..."

10 Do të kaloj në fund:

11 "... dhe i kaluam, u transmetuam rregulloren e policisë
12 ushtarake për batalionin dhe disa sqarime që u paraqitën nga
13 disa nga shokët tanë".

14 Pyetja ime për këto tre shënime të 15 dhe të 19 gushtit
15 është si më poshtë: Në verën e 1998 a ka ndodhur e njëjta gjë
16 edhe në batalionin tënd? Dhe me këtë e kam fjalën a ju janë
17 transmetuar rregullat e policisë ushtarake dhe ushtarëve nën
18 komandën tënde?

19 PË. Po, po ai ka qenë takim i veçantë me policinë pa
20 prezencën time.

21 PY. Nëse të kujtohet kush e ka mbajtur këtë takim?

22 PË. Normal, ky që e ka mbajtur këtu, Haxhi Shala.

23 PY. Kam një pyetje të fundit lidhur me këtë dokument.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 8 në të dy
25 këto. E ka numrin U001-9732.

1 PY. Që është e një shënimi të 13 gushtit. Dy pjesët për të
2 cilat jam i interesuar kanë të bëjnë me 13 gusht 1998.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ta zbresim pak faqen në gjuhën
4 shqipe ose ta ngremë më qartë.

5 PY. Ku thuhet më 13 gusht dikush, emri i të cilit nuk po e
6 lexoj, është ndaluar me armë dhe pa lejeqarkullimi. A është ky
7 një pasqyrim i faktit që policia ushtarake kontrollonte lejet
8 e qarkullimit dhe lëvizjet e popullatës?

9 PË. Po, saktë.

10 PY. Dhe shënimi tjetër, nuk po lexoj emrat, po thuhet, jepet
11 emri i personit dhe thuhet që "u informuam me gojë që ai është
12 një person i dyshuar".

13 Dhe lidhur me këtë shënim, pyetja është që: A reflekton
14 kjo dëshminë tënde që personat e dyshuar i raportoheshin
15 policisë ushtarake? Ju vetë na keni dhënë disa shembuj në
16 deklaratat tuaja.

17 PË. Po, e saktë është.

18 PY. Dakord.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja
20 paraqet për provë për pranim këtë dokument si dhe
21 konfidenciale për shkak të natyrës së informacionit.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë në të njëjtën
23 mënyrë. Të gjitha dëshmitë provuese që ka dhënë ky dëshmitar,
24 i ka dhënë përpara se t'i tregohej ky dokument. Dhe ajo që po
25 bën kolegja është që të kontrollojë një dokument për të cilin

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 29

1 nuk e ka hartuar ai vetë, pra, këtë ka bërë Avokatja. Dhe në
2 këtë mënyrë ka marrë disa shembuj dhe i kërkon dëshmitarit që
3 ta konfirmojë. Dhe, në fakt, ky është konfirmim i dëshmisë që
4 ai ka dhënë vetë tashmë.

5 Edhe në qoftë se e pranojmë faktin që kjo ka vlerë
6 provuese në vetvete, që për mendimin tonë, nuk është ashtu,
7 pasi nuk bëhet fjalë për të njëjtat incidente. Dëshmitari ka
8 dhënë dëshmi nga përvoja e tij. Në këtë dokument nuk ka asgjë
9 që i shton asaj dëshmie, por, në fakt, është shkelje e të tëra
10 parimeve dhe kryesisht bëhet fjalë për një material i cili nuk
11 e ndihmon në mënyrë të veçantë apo të pavarur Trupin Gjykses
12 dhe vlera provuese e secilit do të duhet të vlerësohet.

13 Por, e dyta, bëhet fjalë që me gjetjen e pikave të cilat
14 përkojnë apo pikat për të cilat Avokatja i kërkon dëshmitarit
15 të thotë "A pasqyron kjo mënyrën sesi ka funksionuar një gjë?"
16 edhe kjo më duket se është një shfrytëzim për të paraqitur për
17 pranim si prova një numër shumë të madh dokumentesh në mënyrë
18 të pajustificueshme.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
20 shënojmë. A dëshiron ndokush tjetër të bëjë ndonjë
21 kundërshtim?

22 PËRKTHYESI: Avokatët e Mbrojtjes: Edhe ne i bashkohemi
23 kundërshtimit të paraqitur.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po përgjigjem shkurtimisht, të
25 nderuar Gjykatës.

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 30

1 Dëshmitari e ka njohur këtë dokument, firmën e komandant
2 Topit, ai ka dhënë momentin kohor, është lidhur me dëshminë që
3 ka dhënë ai vetë, ka nënvijëzuar se e njëjta gjë ka ndodhur në
4 batalionin e tij, të njëjtat ngjarje të cilat përshkruhen që
5 kanë ndodhur brenda batalionit të tij. Dhe për këto arsye ky
6 dokument e përmbush *prima facie* të gjithë kriteret e
7 pranueshmërisë. Dhe prandaj ne e paraqesim për pranim si provë
8 materiale.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Të sqarojmë pozitën tonë. Ne nuk e
11 kundërshtojmë faqet të cilat i janë treguar dëshmitarit. Ne
12 kundërshtojmë paraqitjen e të tërë dokumentit.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne i kemi
14 treguar të gjitha këto faqe dëshmitarit, vetëm pak, shumë pak
15 kanë ngelur jashtë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Mund të vazhdoni me pyetjet tuaja.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] ERN U001-9725 deri në
19 9732 do të shënohet për identifikim me 11123 e klasifikuar si
20 konfidencial.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi arritur
22 pothuajse në orën 10.00. Do marrim një pushim dhjetë minutësh.

23 Dëshmitar, do marrim një pushim prej dhjetë minutash, ju
24 lutem të largoheni nga salla me ndihmën e Asistentes.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do
2 marrim pushim dhjetë minuta.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 9.59

4 --- Seanca rifillon në orën 10.22

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkojmë
6 falje për vonesën. Dhe për këtë mund të dënohem unë për mos
7 bindje të Gjykatës. Do vazhdojmë tani me dëshmitarin.

8 I lutem Asistentes të sjellë dëshmitarin në sallë.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,
11 Dëshmitar. Mirë se u kthyet. Prokuroria ka ende disa pyetje
12 për ju.

13 Vazhdoni, znj. Prokurore.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, do të kalojmë në temë tjetër. A keni marrë
16 pjesë ju në festimet e ditës së flamurit të 28 nëntorit 1998
17 në malet e Berishës?

18 PË. Po.

19 PY. Dua t'ju tregoj një artikull lidhur me këto festime.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Artikulli mban numrin

21 SPOE4000012 dhe përkthimi në gjuhën angleze me të njëjtin
22 numër dhe do lutesha që të shfaqeshin të dy materialet në
23 ekran.

24 PY. Dëshmitar, dokumenti që do shfaqet në ekran është
25 artikull i *Zerit të Kosovës* i verës së 1998, ku flitet për

1 festimet e ditës së flamurit më 28 nëntor 1998. Mund ta shihni
2 në ekran. Mund të shihni dhe versionin origjinal.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem ta zmadhojnë më shumë
4 shqipen.

5 PY. E ka shkruar Nuhi Bytyqi. Dëshmitar, a ju kujtohet ajo
6 ditë?

7 PË. Shkrimi s'më kujtohet, a dita kur kam marrë pjesë në atë
8 ditë festive po.

9 PY. Po, kjo ishte pyetja ime. E kuptoj që për artikullin nuk
10 e keni lexuar. Do lexoj nga fillimi deri tek pjesa me shkronja
11 të zeza.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Zbrisni pak më poshtë në shqip.

13 PY. "Nisur atë ditë të ftohtë nëntori morëm pjesë në
14 kremtimin e 28 nëntorit të festës sonë kombëtare...".

15 Ju kujtohet si ka qenë koha atë ditë?

16 PË. Po.

17 PY. "Ishte pjesëmarrja jonë e parë në një festim të tillë në
18 kushte lufte me rastin e 28 nëntorit ..."

19 Po kaloj disa rreshta.

20 "... u mbajt në malet e Berishës, të veshura me petkun e
21 bardhë".

22 Besoj se ju e konfirmuat në fakte si kanë qenë kushtet
23 atmosferike atë ditë.

24 "Organizatorët e kësaj feste ishin pjesëtarët e zonës së
25 Pashtrikut ..."

1 Kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Artikulli më pas flet për z. Shefqet Bucaj që ka hapur
4 ceremoninë dhe z. Jakup Krasniqi që ka folur në emër të
5 Shtabit të Përgjithshëm. Ju kujtohen këta folës?

6 PË. Po.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në anglisht mund të shkojmë në
8 faqen 3.

9 PY. Ndërsa në shqip, do shohim rreshtin e tretë, ku përmendet
10 Shaban Dragaj të cilin e ke përmendur në dëshminë tuaj dhe ka
11 qenë që shefi i operativ i Brigadës 121, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Po ju lexoj diçka që ka thënë z. Dragaj. Ai thotë:

14 "Në UÇK ekziston një komandë unike, një hierarki e cila
15 respektohet duke filluar prej skuadrave e deri tek Shtabi i
16 Përgjithshëm. Nuk ekzistojnë kurrfarë grupacionesh apo
17 interesa të ngushtë, por dominon uniteti e vendosmëria për të
18 luftuar deri në fund për të larguar forcat serbe nga Kosova.
19 Këto janë faktorët që dominojnë".

20 Pra, pyetja e parë që kam unë është kjo, ju e dëgjuat
21 çfarë ka thënë Dragaj. Nga përvoja juaj, fjalët që tha ai a
22 pasqyrojnë vërtetë sesi ka qenë struktura dhe organizimi i
23 UÇK-së gjatë kohës që keni qenë ju komandant batalioni në
24 Brigadën 121, për periudhën kohore 1998 dhe 1999?

25 PË. Te batalioni po. Se unë përgjigjem vetëm për batalion. Ka

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 34

1 qenë kështu siç thotë ky.

2 PY. Po, në batalion?

3 PË. Po.

4 PY. Po batalioni si pjesë e brigadës dhe zonës së Pashtrikut
5 do të thoja unë?

6 PË. Po, e saktë.

7 PY. Ajet Kastrati është po ashtu, përmendet në rreshtin e
8 tretë. A mund të na thoni në cilin batalion ka qenë komandant
9 Ajet Kastrati?

10 PË. Ka qenë për një kohë të shkurt ka qenë në Batalionin e
11 Tretë, pas ramjes së Kumanovës.

12 PY. Po, pasi u vra Kumanova në gusht të 1998, kështu?

13 PË. Po.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për hir të kohës, të nderuar
15 Gjykatës, do kërkoja që ky dokument të pranohej në provat
16 gjyqësore me klasifikimin publik.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali që
20 mban numrin SPOE40000012 pranohet dhe merr numrin e provës
21 materiale.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës
23 materiale P011124. Dhe klasifikohet si dokument publik.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

25 PY. Do të kalojmë tani një temë tjetër, Dëshmitar. Në

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 35

1 deklaratën tuaj keni folur për një ekip mjekësh dhe motrash,
2 që ishin 17 persona që shkonin aty ku thërriste nevoja dhe
3 keni përmendur mjekë në Krojmir dhe keni përmendur konkretisht
4 Dr. Jakupin dhe Dr. Nezirin.

5 PË. Naserin.

6 PY. Naserin. Dhe kjo është në dokumentin që mban numrin 11423
7 deri në 361. Dr. Naseri, po. Dr. Naseri.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani dua të më thoni diçka
9 lidhur me dokumentin që mban numrin SPOE00232831 deri në
10 SPOE00232833 edhe përkthimet përkatëse. Ju lutem, të vendosen
11 në ekran.

12 PY. Dëshmitar, në dëshminë tuaj në intervistën me ZPS-në ju
13 keni thënë, flitet për vitin 1998:

14 "Kur personat e kuptuan që ne, si UÇK, kishim marrë
15 pozitë atje dhe ishim të pranishëm, filluan të na sillnin
16 ndihmë, të na sillnin ushqime ..."

17 Ju kujtohen furnizimet për të cilat keni folur në
18 deklaratën tuaj?

19 PË. Po. Po këto jua kanë pru drejtpërdrejt mjekëve.

20 Domethënë, këto ndihma kanë ardh nga Nënë Tereza, nga
21 vullnetarë të ndryshëm që kanë pas mjete, kanë pas mundësinë.

22 PY. Po. Kuptoj që kanë qenë dhurime dhe ju keni marrë dhurime
23 në Krojmir edhe ndihmë mjekësore, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Po ambulancë keni pasur në Krojmir?

1 PË. Po.

2 PY. Këtu në ekran shohim regjistrin e donatorëve të UÇK-së që
3 kanë ndihmuar UÇK-në me të mira materiale. Do të doja që ju të
4 fokusoheni në disa pika këtu.

5 Shohim pikën numër 1 që mban datën e qershorit të 1998.
6 Dhe thotë "lloji i të mirave materiale, laborator dhe është
7 dorëzuar në ambulancën e Krojmirit".

8 PË. Po. Atëherë unë s'e kam ditë, domethënë, këto çka janë
9 ardhë, mirëpo ka ekzitu ambulanca dhe këta mjekët. Dhe ata
10 kanë pas të drejtën me i pranë të gjitha mjetet që u kanë
11 sjellë donatorët.

12 PY. Shohim pikën 8 deri në 10, këto janë mjekime me vlerë të
13 ndryshme që po ashtu janë dorëzuar në ambulancën e Krojmirit,
14 këtu është korrik dhe gusht të 1998. A kanë funksionu vërtetë
15 gjërat kështu, të paktën nga ato që keni parë ju në ambulancën
16 në Krojmir deri në verën të 1998?

17 PË. Po. Ambulanca ka qenë shumë e kompletume me të gjitha
18 pajisjet për ndihmë edhe ushtarëve dhe popullatës.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dokumenti
20 është sekuestruar nga banesa e Jakup Krasniqit në Prishtinë
21 dhe ne kërkojmë që të pranohet në provat gjyqësore si dokument
22 publik.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] E kundërshtojmë. Pikë së pari i
24 njëjti kundërshtim lidhur me kontrollimin që është bërë, po më
25 konkretisht lidhur me këtë dokument, dëshmitari as ka thënë që

1 e ka parë ndonjëherë këtë dokument më përpara. As ka
2 konfirmuar ndonjë prej shënimeve në këtë dokument, tha që nuk
3 e ka ditur konkretisht se çfarë të mirash janë marrë. Dhe në
4 këto rrethana e vetmja gjë që kemi ne është që dëshmitari e ka
5 konfirmuar se UÇK-ja në përgjithësi ka marrë donacione prej
6 personave dhe kjo nuk është një çështjet që ne kontestojmë në
7 këtë proces gjyqësor. Kështu që s'është nevoja të pranohet ky
8 dokument. Nuk është relevant. Dhe as nuk është bërë
9 autenticiteti i dokumentit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
11 SPOE00232831-232833 pranohet. Sepse përmbush *prima facie*
12 rregullat për pranim në bazë të rregullës 138.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po. Merr numrin e provës
14 materiale P01125 dhe klasifikohet si konfidencial.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në një
17 parashtrim të protokolluar do t'ju dorëzojmë të gjitha
18 informacionet që keni kërkuar lidhur me materialet e
19 sekuestruara dhe këtu e kam fjalën për udhëzimin që keni dhënë
20 më 15 janar.

21 Tani do lutesha të shfaqej në ekran materiali
22 SPOE00225149 bashkë me përkthimin në gjuhën angleze.

23 Gjithashtu, lidhur me dokumentin paraprak, dokumentin e
24 parë - më falni - kërkojmë që të jetë dokument publik.

25 PY. Dëshmitar, ndërkohë që presim që të shfaqet dokumenti në

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 38

1 ekran, do të doja të flisnim për një person që e keni
2 përmendur, Dr. Fitim Selimin, që punonte në zonën e Shalës, me
3 Batalionin e Parë. A ju kujtohet?

4 PË. Po.

5 PY. Këtu kemi një raport.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë deri në fund në mënyrë
7 që dëshmitari ta shoh të plotë dhe kush e ka nënshkruar këtë
8 raport.

9 PY. E shihni nënshkrimin në fund të dokumentit, Dëshmitar?

10 PË. Po. Unë e di që ka punë në ambulancë, jo në zonë të
11 Shalës, po në fshatin Shalë, Dr. Fitimi. Ka qenë përgjegjës i
12 atyne mjekëve. Jo që e ka pa ndonjëherë nënshkrimin e tij, po
13 ai ka qenë aty si mjek.

14 PY. Po. Gjithashtu në seancën përgatitore keni thënë se këtë
15 dokument nuk e kishit parë më përpara? Për herë të parë e keni
16 parë gjatë seancës përgatitore, kështu?

17 PË. Ashtu është. Normal. S'kam mujt me e pa unë këtë.

18 PY. Nëse nuk keni qenë në pozita, sepse nuk keni qenë në
19 pozita që ishte e nevojshme që ta shihnit këtë dokument, apo
20 jo?

21 PË. Unë kam qenë komandant batalioni, s'kam mujt me e pa këtë
22 dokument.

23 PY. Dua t'ju bëj disa pyetje në lidhje me këtë, për
24 përmbajtjen e dokumentit.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë lart që të shohim

1 pjesën e parë të raportit.

2 PY. Z. Selimi, pra, Fitim Selimi, këtu raporton lidhur me
3 situatën shëndetësore në gjithë territorin dhe thotë:

4 "Domethënë, kujdesi shëndetësor ofrohet në këto -- në
5 terrenin e për lartë shënuar zhvillohet veprimtaria
6 shëndetësore në pikat si vijon: Krojmir, Shalë, Nekovc,
7 Kisharekë, Ngucat, Bellanicë ..." e me radhë.

8 Pastaj flet për punëtorët shëndetësorë edhe specialitetet
9 e tyre, specialitet e secilit prej tyre. A përputhet kjo me
10 atë që dini dhe ju se ku ofrohej kujdesi shëndetësor në zonën
11 ku vepronit dhe ju?

12 PË. Po.

13 PY. Shkojmë poshtë në paragrafin e katërt, ku thotë:

14 "Furnizimi me mjete të punës dhe material bëhet kryesisht
15 nga burime humanitare si dhe nga donatorë vullnetarë. Sasia e
16 mjeteve për këtë destinim nga fondi i ushtrisë është e vogël".

17 Po ky informacion a përputhet me atë që ju kujtohet ju
18 nga ajo kohë?

19 PË. E saktë është.

20 PY. Në rregull.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, edhe ky
22 dokument është sekuestruar nga shtëpia e z. Krasniqi dhe
23 kërkohet që të pranohet në provat gjyqësore si dokument
24 publik.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] I njëjti kundërshtim. Sa i takon

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 40

1 kontrollimit po dhe për dëshmitarin, dëshmitari thotë që këtë
2 dokument s'e ka parë më përpara, as nënshkrimin s'e ka parë më
3 përpara, kështu që nuk mund të jetë personi që të vërtetojë
4 përmbajtjen e këtij dokumenti.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ne po themi që ky dokument
6 njësoj si dokumenti paraprak është dokument që mund të
7 pranohet në bazë të provave jo-gojore dhe fakti që dëshmitari
8 ka folur për këtë dokument dhe ka vërtetuar disa nga pjesët e
9 përmbajtjes mendojmë që është një dokument që përmbush
10 kriteret e rregullës 138.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet në
12 bazë të rregullës 138.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës
14 materiale 01126 dhe klasifikohet si publik.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, a dini kush është Qerkin Duvelli?

17 PË. Dugolli

18 PY. Dogolli.

19 PË. Ka qenë në brigadë diçka, në personel të brigadës.

20 PY. Në listën e pjesëtarëve të batalionit që i keni dhënë

21 ZPS-së dhe që unë e përmenda më herët që është prova materiale

22 P1116, në faqen 45, ju keni renditur mes anëtarëve të policisë

23 ushtarake dhe batalionit tuaj Ajvaz Korpuzin, që keni thënë që

24 është dhe zëvendës, Sylë Qeriqin, Agron Orullin --

25 PË. Ollurin.

1 PY. -- Ollurin, Ju kujtohen?

2 PË. Po.

3 PY. Të kujtohet?

4 PË. Po.

5 PY. A keni dijeni të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj
6 ndonjërit prej këtyre policëve dhe nëse është marrë ndonjë
7 masë disiplinore kundër tyre, kur ka ndodhur?

8 PË. Unë s'kam qenë këtu në atë kohë. Ka qenë në 1999 dikun,
9 fillimi i 1999. Vetëm që më kanë tregu, se s'kam qenë këtu.

10 PY. Kuptoj. Po unë po ju pyesja nëse keni dijeni. A ju
11 kujtohen emrat e policëve që kanë qenë objekt i këtyre masave
12 disiplinore?

13 PË. Tash, po e them prapë, nuk kam qenë këtu. Kam qenë në atë
14 kohë përgatitje për luftë të Kosharës. Po këtu janë komplet
15 ekipi mjekësor kish pas problem e komandën. Domethënë, i kanë
16 marrë në pyetja ata të brigadës, komplet ekipin e policëve të
17 Krojmirit, ça kanë qenë në Krojmir. Këtë ma kanë thënë mbasi
18 jam kthyer prej atje. Për shkak se janë sjellë keq dikun me një
19 qytetar. Por kjo është e thënë prej tyne.

20 PY. E kuptoj këtë. Më intereson më shumë të di a ju
21 kujtoheshin emrat e këtyre policëve.

22 PË. Po është Agroni. Agroni, është Azemi. Agron Olluri, Azem
23 Olluri. Këta kanë qenë në atë kohë. Komplet ekipa. Janë atje
24 dikun të shënu, komplet ekipa qysh ka qenë e policëve.

25 PY. Në rregull. Do të flasim tani tek tema e fundit që kam.

1 Dëshmitar, ju e dini nga intervistat e mëparshme sepse ua kanë
2 dhënë me detaje informacionin se ekzistojnë, ka pretendime se
3 ju keni marrë pjesë në arrestime, marrjen në pyetje dhe
4 keqtrajttime të civilëve. Jeni në dijeni për akuza të tilla,
5 apo jo?

6 PË. Asnjëherë s'kam qenë në këto. Asnjëherë s'kam marrë pjesë
7 në këto gjëra. Unë ju kam tregu juve, domethënë, për gjithçka.

8 PY. Pra, dëshmia jote është që ti vetë nuk ke marrë pjesë në
9 arrestime, marrje në pyetje e kështu me radhë?

10 PË. Asnjëherë.

11 PY. Përfshirë këtu persona të cilët më pas janë transportuar
12 apo që kanë përfunduar në qendrën e ndalimit në Llapushnik?

13 PË. Nuk jam marrë me to.

14 PY. Z. Qeriqi, atëherë, ajo që kam për të thënë është si më
15 poshtë, do të paraqes pikëpamjen time dhe do kërkoj komentin
16 tuaj, duke patur parasysh atë që na keni treguar.

17 Propozimi ynë si ZPS është se ti ke luajtur rol shumë më
18 të madh sesa dëshiron të pranosh lidhur me këto pretendime, që
19 ti ke urdhëruar apo ke marrë pjesë në arrestimin e civilëve të
20 cilët kanë përfunduar në paraburgim në Llapushnik, që ti ke
21 marrë pjesë në keqtrajtimin dhe ke urdhëruar ushtarët tuaj që
22 t'i keqtrajtonin civilët gjatë marrjes së tyre në pyetje.

23 Propozimi është po kështu që ju keni patur dijeni mbi këtë dhe
24 vazhdoni ta mohoni këtë rol që keni luajtur personalisht.

25 Dhe dua të dëgjoj se çfarë është përgjigja juaj ndaj

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 43

1 këtij propozimi.

2 PË. Asnjëherë s'kam -- s'jam marrë me ato se unë kam pas punë
3 me frontin. Kam qenë në front s'kam qenë pjesë e këtyne
4 gjënave.

5 PY. E kuptoj.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këto ishin
7 pyetjet që kisha për të bërë. Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Roberts, ju e keni fjalën.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni një
11 çast sa të përgatis dosjet e mia.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndërkohë që z. Roberts po bën
13 këtë, unë ju kam thënë që vlerësimi im është më i gjatë sesa
14 kisha parashikuar për të bërë pyetjet e mia. Mirëpo, siç
15 shihet situata, unë nuk pres që të kem pyetje fare ose dhe po
16 të kem pyetje do të jenë shumë të shkurtra.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
18 për këtë përditësim.

19 A dëshiron ndokush tjetër që të njoftojë sesa minuta do
20 të kenë në dispozicion? Minuta, jo orë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë kam rreth 45 faqe, kështu që
22 po i qëndroj vlerësimin që kam dhënë më përpara.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere po e
24 quaj një orë.

25 Z. Ellis?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe unë i përmbahem parashikimit të
2 kohës që ju kam dhënë, i nderuar Gjykatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
4 Roberts.

5 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

6 Z. ROBERTS: [Përkthim]

7 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Kam dhjetë minuta në dispozicion
8 deri në marrjen e pushimit, do filloj me pyetjet e mia dhe
9 pastaj do të vazhdojmë më tutje pas pushimit.

10 Po e filloj me mbërritjen tënde në Kosovë dhe unë besoj
11 që kjo ka ndodhur në prill të 1998. Ju i thatë ZPS-së, lidhur
12 me mbërritjen tuaj që keni hyrë në Kosovë, keni shkuar në
13 Likoc me një grup prej nëntë apo dhjetë personash pasi kishit
14 takuar në Tiranë Azem Sylën, kështu është?

15 PË. Më falni, ju përfaqësoni? Avokat i kujt jeni?

16 PY. Ju kërkoj ndjesë, unë jam Avokat i z. Rexhep Selimi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk e
18 keni paraqitur veten tënde.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar
20 Gjykatës. Kujtova se e bëtë ju në emrin tim. Nganjëherë e kam
21 bërë këtë. Më vjen keq po e paraqes edhe një herë veten time.

22 PY. Unë jam Avokati i z. Rexhep Selimi. Atëhere po e përsëris
23 pyetjen që kisha.

24 I thatë ZPS-së që kur kemi hyrë në Kosovë për herë të
25 parë keni mbërritur nga Tirana në Likoc me një grup prej nëntë

1 apo dhjetë personash të tjerë, pasi kishit takuar më parë në

2 Tiranë z. Azem Syla, a është e saktë?

3 PË. E saktë.

4 PY. Përpara se të hynit në Kosovë, ju vetë nuk e keni njohur
5 ndonjëherë z. Rexhep Selimi personalisht, apo jo, nuk e kishit
6 takuar asnjëherë?

7 PË. Jo. Asnjëherë.

8 PY. Pra, emri që të kishin dhënë apo nofka Agroni apo
9 Dhjetëshi, këto ishin nofka të cilat ty t'i kanë treguar
10 persona përpara se të hyje në Kosovë, kështu është?

11 PË. Po. Jo persona, po Azem Syla.

12 PY. E kuptoj. Kur mbërritët ju i keni thënë ZPS-së që i keni
13 dërguar, i keni dhënë një letër Agronit apo Dhjetëshit ku i
14 thatë që ishit, nga ku vinit, letër të cilën ti vetë nuk e
15 kishe lexuar përpara se të mbërrije, kështu është?

16 PË. Ashtu është.

17 PY. Dhe këtë ti nuk e ke parë asnjëherë se çfarë përmbante
18 kjo letër të cilën ia ke dorëzuar atij, pasi kjo letër ishte e
19 dyllosur besoj, apo jo?

20 PË. Ka qenë e mbështjellun me një letër të thjeshtë, të
21 thjeshtë them kështu, sikur letër e thasëve dhe ka qenë me një
22 izoler e mbështjellun që mos me u lag, mos me u prish në rast
23 se bien në ujë a diku. Ashtu.

24 PY. Por nuk ke parë asnjëherë se çfarë ishte shkruar në atë
25 letër edhe pasi arrite në Likoc, apo jo?

1 PË. Jo, s'e kam pa vetëm që --

2 PY. Pra, ia dhe ashtu të mbyllur z. Selimi, ai e hapi dhe e
3 lexoj atë në praninë tënde, kështu ishte?

4 PË. Po. S'më kujtohet taman, po ashtu është. Ashtu është.
5 Ashtu.

6 PY. Kjo ka ndodhur në Likoc apo diku jashtë, ku ekzaktësisht
7 ike takuar ata?

8 PË. Atëherë kam thënë se është Likoc se unë vetëm atëherë kur
9 kam qenë në Likoc, se unë s'kam qenë as pas luftës, atëherë
10 nja dy herë kam qenë, në Likoc kanë thënë, ashtu e kam dit si
11 në Likoc.

12 PY. Po a ishte në qendër të Likocit apo në fshatrat përreth
13 apo nuk e di ekzaktësisht se ku ishte?

14 PË. Të them të drejtën më s'kam qenë aty. E di që ka qenë një
15 fshat dhe ka qenë ajo ambulanca që e përmenda më herët. Kanë
16 qenë disa shtëpi ku kan flejt nëpër ato fshatra. Kështu ka
17 qenë.

18 PY. Për shkak se këtë letër nuk e kishe parë ti, nuk e di
19 nëse ajo letër ishte drejtuar me emër z. Selimi dërguar nga z.
20 Sylja?

21 PË. Ju lutem. Azem Sylja më ka thënë se, për afërsisht, ka
22 thënë "Në qoftë se të humb kjo letër është vetëm se i kam
23 njoftu Dhjetëshin që për që ke me shkue në atë pjesën anej të
24 Drenicës, domethënë, ka fshati jem. Nëse të humb kjo, kjo e ka
25 përmbajtjen". Ça ka shkru aty unë nuk muj me dit, s'e kam pa.

1 PY. Në dëshminë që keni dhënë në gjyq përpara Tribunalit të
2 Hagës, është prova materiale P114, ju shpjeguat që z. Syla ka
3 treguar se ku do të dërgoheshit dhe cilat ishin detyrat që do
4 të kryeje, pavarësisht se këtë ta ka dhënë me gojë z. Selimi,
5 është e saktë? Është në paragrafin -- është me numrin e
6 referencës P114.

7 PË. Kush ma ka dhënë?

8 PY. Pra, z. Syla ka shkruar se çfarë kishe ndërmend të bëje,
9 ku do të shkoje dhe çfarë detyrash do të duhej të kryeje por
10 këtë informacion ta ka dhënë gojarisht z. Selimi pasi
11 mbërrite, a është e saktë, apo jo? Unë mund ta lexoj citimin
12 nga dëshmia që ke dhënë --

13 PË. E saktë, E saktë.

14 PY. -- në qoftë se kjo e lehtëson kujtesën?

15 PË. E saktë. Ashtu qysh e kam thënë atëherë s'ka ndryshu
16 asnjë.

17 PY. Pra, z. Selimi, sipas dëshmisë suaj ka lexuar me zë të
18 lart atë që kishte shkruar në atë letër z. Syla, pra, se ku do
19 të shkoje dhe cilat do të ishin detyrat që do të kryeje.
20 Kështu e ke kuptuar ti?

21 PË. Nuk ka pas nevojë me lexu me zë të lart sepse ne e kemi
22 pas besimin atëherë dhe ajo detyrë që na u ka dhënë e kemi
23 zbatu. Ke me shku këtu, këtu. Unë s'kam vendos se ku do të
24 shkoj po ka vendos dikush tjetër.

25 PY. Pyetja që po përpiqem të bëjë, ishte që z. Selimi po

1 lexonte atë që kishte shkruar z. Syla. Ishte z. Syla ai që
2 kishte vendosur ose sugjeruar që ti të shkoje në Krojmir, a
3 nuk është kështu?

4 PË. Sigurisht që z. Syla bashkë me Rexhep Selimin. Nuk muj me
5 dit unë saktë në atë kohë se kush ka vendosë. Por un kam qenë
6 i atij vendi. Kam pas shokë të organizum ma herët. Edhe kur e
7 kam bë kërkesën në Aargau, ju kam thënë që unë muj me vepru në
8 atë pjesë të Drenicës, për atë më kanë çu q'aty.

9 PY. Pra, ti i the z. Syla që mund të shkoje në Krojmir,
10 kështu është? Për shkak se kishe shokë atje dhe ishte e
11 logjikshme, pra, që të shkoje pikërisht në atë vend?

12 PË. Normal.

13 PY. Unë mendoj që i ke thënë ZPS-së - P1115.1, faqja 32 - që
14 nuk ishte nevoja që të thonin se në ç'vend të shkoje?

15 PË. Si?

16 PY. I thatë ZPS-së që s'kishe nevojë që të merrje udhëzime se
17 në ç'drejtimit të shkoje dhe po e marr mend se e ke menduar se
18 ishte krejtësisht normale që ti të shkoje në Krojmir vendi nga
19 i cili vjen, apo jo?

20 PË. Atëherë është një kohë shumë e gjatë. Mirëpo aty edhe më
21 kanë caktu. Se kanë kërku ku unë me shërby ma lehtë. Këtu. Aty
22 të kanë caktu atëherë personat që kanë qenë përgjegjës për
23 këtë punë dhe aty kam shku ku më kanë thanë.

24 PY. Nëse të kujtohet sa kohë ka zgjatur ky takim me z.
25 Selimi? Unë besoj që ka qenë shumë i shkurtër për nga dëshmia

1 që keni dhënë, po a mund të na sqarosh?

2 PË. I shkurt ka qenë. Nuk muj me dit saktë sa. Ashtu qysh the
3 i shkurtër.

4 PY. Dhe ke shpjeguar po kështu që, me sa di ti, askush nga
5 ata personat me të cilët ishin në atë grup nuk kishte udhëzime
6 të ngjashme se ku të shkonte, pra, udhëzime të tilla të dhëna
7 nga z. Sylja?

8 PË. Edhe një herë ma spjego?

9 PY. Sigurisht. Në dëshminë tënde për ZPS-në, Pjesa 1, ju
10 pyetën:

11 "... a ishe personi i vetëm që kishte marrë urdhër nga z.
12 Azem Sylja?"

13 Dhe përgjigja jote ishte që:

14 "Ai mund t'i kishte dhënë udhëzim ndokujt tjetër për të
15 cilin unë nuk kam dijeni, por nuk besoj".

16 PË. Nuk besoj. Po.

17 PY. Po sipas mendimit tonë t'i ishe i vetmi person i cili
18 kishte marrë udhëzim të tillë.

19 PË. Unë mendoj që vetëm mu ma ka dhënë atë udhëzim. Kam qenë
20 përgjegjës i atij grupi. Mirëpo aty kur kemi ardhë në Likoc
21 jemi shpërnda. Shembull, komplet grupi nuk është ardhë ku kam
22 shku unë në Krojmir apo në Kleçkë, domethënë, Krojmir. Disa
23 janë ndalë aty që kanë qenë ma të afërt. Shembull, një Muhamet
24 është ndalë Likoc, një tjetër një Sabir është shku dikund
25 tjetër, se ka shku në atë zonën e vet. Domethënë, na të gjithë

Dëshmitari: Ramiz Qeriqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 50

1 nuk kena shku në Kleçkë e Krojmir.

2 PY. Pra, gjatë këtij shkëmbimi, z. Selimi të çoi në drejtim
3 të Krojmirit duke zbatuar atë që kishte shkruar z. Sylja. A
4 mund të kishe shkuar diku tjetër, për shembull?

5 PË. Po të më kish thënë normal që u dasht me shku.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, më duket se
7 është momenti i përshtatshëm për pushim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim
9 një pushim gjysëm ore. Dëshmitar, të lutem mos fol me askënd
10 lidhur me dëshminë tënde lidhur jashtë kësaj salle, mund të
11 largohesh me ndihmën e Asistentes së Gjykatës.

12 DËSHMITARI: Jam i vetëm. Jam i vetëm aty, s'kam me kënd
13 me fol.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

17 --- Pauza fillon në orën 11.01

18 --- Seanca rifillon në orën 11.30

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
20 sillni dëshmitar në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,
23 Dëshmitar, do vazhdojmë me kundërpjetjet nga ana z. Roberts.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

25 PY. Dëshmitar, po flisnim lidhur me takimin që keni pasur me

1 z. Selimi kur shkuat për herë të parë në Kosovë. Që të jemi të
2 qartë, z. Selimi nuk ju emëroi ju në ndonjë pozitë të caktuar
3 në ato momente? Ai thjesht ju udhëzoi të shkonit në drejtim të
4 Krojmirës, kështu?

5 PË. Aty ne jemi taku dhe me Fatmir Limën. Po ka qenë
6 rastësisht dhe kam shku bashkë me Fatmirin. Atëhere unë --

7 PY. Po. Po që të jemi të qartë, z. Selimi nuk të dha ndonjë
8 pozitë. Ai thjesht, të lexoi çfarë kishte të shkruar në letër
9 dhe të udhëzoi që të shkoje në Krojmir. Por nuk bëri ndonjë
10 emërim zyrtar në ato momente?

11 PË. Në atë moment, në atë kohë nuk është bë ndonjë emërim.
12 Mirëpo unë kam shku në atë kohë me Fatmir Limën bashkë për në
13 Kleçkë, Krojmir.

14 PY. Dhe, siç e thoni dhe në intervistën me ZPS-në, ju jeni
15 emëruar zyrtarisht vetëm më 16 gusht dhe këtë e ka bërë Fatmir
16 Limaj, apo jo?

17 PË. Ju lutem, unë nga ajo ditë që kam shku në Krojmir, që kam
18 udhëtu me Fatmir Limën dhe i kam raportu Fatmir Limës që nga
19 fillimi. Në letër i ka hedhë ai në atë kohë kur po thoni ju,
20 ndërsa më herët, domethënë, nuk ka qenë aty, nuk kam qenë në
21 vete. Unë i kam raportu Fatmirit, Fatmiri kujt i ka raportu
22 nuk muj me ditë. Po që nga fillimi detyrat dhe punët,
23 domethënë, i kam marrë nga Fatmir Limaj. Nuk ka qenë ajo, unë
24 në vete s'kam shku atje.

25 PY. Po, do flasim dhe për raportimin. Tani e kisha fjalën për

1 emërimin. Më interesonte emërimi.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do të doja të shihnim një dokument
3 që e patë edhe sot paradite, që mendohet se është një bllok
4 shënimesh që mban numrin P1122, ERN është IT-03-66. Të presim
5 që të shfaqet në ekran.

6 PY. Ju kujtohet që ua tregoj Prokurorja këtë dokument?

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe do të doja që të shihnim të
8 njëjtat faqe që ju tregoj dhe Prokurorja, pjesa ku lexon "Një
9 ditar i vonuar" dhe ishte faqja 4 në anglisht.

10 PY. A ju kujtohet që diskutuat lidhur me hyrjen tuaj, futjen
11 tuaj në Kosovë dhe se ku shkuat nga momenti i mbërritjes në
12 Kosovë?

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Presim që të dali dhe shqipja.

14 PY. Të jemi të qartë, s'kemi nevojë të hyjmë më në detaje,
15 këtu nuk përmendet fare as z. Selimi dhe as Agroni? Dhe, ju
16 lutem, mund ta lexoni dhe një herë këtë paragraf nëse është e
17 nevojshme. Këtu flitet në momentin që keni hyrë në Kosovë, por
18 nuk përmendet z. Selimi, as Dhjetëshi, as Agroni.

19 PË. Ky është një ditar i Qerqizit. Tregon dhe ky që kemi
20 ardhë në Likoc. Unë e kam thënë atë timen. Ky e ka shkru në
21 ditarin e vet. Është shumë e vërtetë që bashkë me këto kemi
22 ardhë na me Qerqizin. Këtu una s'un e lexoj dhe s'kam çka --

23 PY. Ju e lexuat më përpara ose më saktë jua lexoj Prokurorja?

24 PË. Prokurorja. Po.

25 PY. Po më korrigjoni nëse e kam unë gabim. Unë po ju them që

1 në këtë pjesë këtu nuk përmendet fare z. Selimi?

2 PË. S'e ka përmend ai. S'e di çka po doni me thënë me këtë.

3 PY. Unë po dua të them këtë që në dëshminë tuaj keni thënë ai
4 është personi që më çoi drejt Krojmirës - do flasim edhe më
5 vonë çfarë keni menduar ju lidhur me pasojat e kësaj - por ama
6 nuk përmendet fare në udhëtimin tuaj nga Likovci drejt
7 Krojmirës.

8 PË. Kush nuk përmendet?

9 PY. Z. Selimi. Z. Selimi, personi që ju thatë që se e kishit
10 takuar dhe që mendohet që ju paska udhëzuar të shkonit drejt
11 Krojmirës.

12 PË. Po z. Selimi s'është ardhë nga me neve. Unë thashë kena
13 shku me Fatmir Limën anejna deri në Kleçkë edhe -- po.

14 PY. Nuk po e vë në dyshim këtë.

15 PË. Po.

16 PY. Unë po them që këtu nuk përmendet fare në këtë paragraf
17 z. Selimi që ju paska thënë ju të shkonit në këtë vend.
18 Megjithatë, mund të vazhdojmë sepse ju nuk po e kontestoni
19 këtë.

20 PË. Jo.

21 PY. I keni thënë ZPS-së --

22 PË. Ajo -- unë atë që e kam thënë atëherë, qëndroj pranë
23 asaj. Domethënë, se këtu është një ditar i tjetërkujt,
24 domethënë, i Qerqizit. Ndërsa unë jam Ramiz Qeriqi, Luani.
25 Edhe kam fol unë për atë pjesën siç ka qenë.

1 PY. Që të jemi të qartë, unë po them ju po thoni që në të
2 vërtetë nuk përmendet në këtë ditar, për këtë të jemi të
3 qartë. Ai nuk përmendet në ditar.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E kundërshtoj.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
6 përgjigjeni, Dëshmitar.

7 Përsëriteni edhe një herë pyetjen, z. Roberts.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim]

9 PY. Që të jemi të qartë, Dëshmitar, për procesverbal, ju nuk
10 po thoni që ai përmendet në këtë pjesë të ditarit, pra, z.
11 Selimi.

12 PË. Ai s'ka pas me përmend se unë e kam pas atë letrën që e
13 kam dhënë z. Selimi, nuk e ka pas Qerqizi.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 përgjigjuni me po ose me jo pyetjes, pyetjeve të paktën që
16 kërkojnë përgjigje me po ose me jo.

17 DËSHMITARI: Si dhe një herë me po, me jo? Ky personi nuk
18 e përmend, po unë e kam përmend.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Besoj se e morëm përgjigjen.

20 PY. Prokurorisë i thatë, lidhur me këtë takim të shkurtër me
21 z. Selimi se ai ishte kryesori në Likovc.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kjo është Pjesa 1 ose përndryshe
23 është prova materiale P1115.1, në faqen 32.

24 PY. Të jemi të qartë, po thoni ju që kjo ka qenë përshtypja
25 juaj lidhur me z. Selimi dhe këtë e keni bazuar në këtë takim

1 të shkurtër me atë në Likovc në prill të 1998?

2 PË. Jo. Mbasi po pyetni ashtu, derisa mu më ka udhëzu Azem
3 Syla te Rexhep Selimi, normal, që ai ka qenë ka qenë më i
4 madhi aty, mbasi po, po e kërkoni.

5 PY. Mua më intereson të di këtë: Sipas asaj që kishit kuptuar
6 ju, pra, sipas kësaj që thoni ju, z. Selimi ishte më i madhi
7 në Likovc dhe ju këtë e bazuat në faktin që e kishte dërguar
8 z. Syla?

9 PË. Normal. Në faktin që më ka thënë me u drejtu te Rexhep
10 Selimi, me ia dhënë këtë letër edhe ai, domethënë, u kuptu që
11 është më i madhi. Ka qenë përgjegjës për atë pikë.

12 PY. Dhe vetëm këtu e bazoni ju këtë që thoni?

13 PË. Jo, vetëm aty. Po unë aty shkova, qëndrova, më udhëzuan me
14 shku në Kleçkë, Krojmir. Domethënë, ka qenë qaq mirë e
15 organizume, nuk ka qenë hajt shko ku dush. Se s'ke mujt me
16 shku ku don. Po as kam mujt me hy ku don. Kam me hy të
17 organizum që nga fillimi deri aty.

18 PY. Po ai vetë në këtë takim të shkurtër nuk të tha asnjëherë
19 që unë jam më i madhi në Likovc, apo jo?

20 PË. S'ka pas --

21 PY. Kur themi "ai" e kemi fjalën z. Selimi.

22 PË. S'ka pas nevojë me thënë jam më i madhi. Se unë jam
23 drejtu te ai. Më ka drejtu dikush te ai. Thashë më herët. Nuk
24 e di pse po e mbështjell.

25 PY. Nëse z. Syla do të kishte çuar tek një person tjetër, a

1 do kishe thënë dhe për këtë person që ky ishte më i madhi?

2 PË. Kudo që të më kishte udhëzu Azem Syla sepse --

3 PY. Po ose jo?

4 PË. -- kudo që të më kishte udhëzu Azem Syla unë q'aty kisha
5 shku, normal. Se ka qenë rregull ushtarak. Kudo që të më
6 kishte çu normal.

7 PY. Dhe personit që do i jepje letrën apo që do të thonin t'i
8 jepje letrën, ti do të thojë që ky person është më i madhi
9 meqë po i jap letrën këtij personi, kështu?

10 PË. Normal është, i nderum.

11 PY. Edhe pas këtij takimi s'e keni parë më asnjëherë z.
12 Selimi, apo jo?

13 PË. Asnjëherë.

14 PY. Dhe as nuk e keni ditur me siguri nëse ka qenë në ndonjë
15 moment ai anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, kështu i keni
16 thënë Prokurorisë, apo jo?

17 PË. Ashtu është. Unë nga kjo kohë kam pas punë me Fatmir
18 Limën, me brigadën, domethënë, kam qenë i organizum në
19 batalion dhe s'kam pas njohuri për Shtab të Përgjithshëm.
20 Ashtu e saktë.

21 PY. Likovci ishte vend i rëndësishëm sepse ishte porta
22 hyrëse, si të themi, për shumicën e shqiptarëve që vinin nga
23 Shqipëria drejt Kosovës, kështu?

24 PË. Ashtu thonin. Unë kam nejt shumë pak në Likovc. Se në
25 fillim ashtu ka qenë.

1 PY. Sa kohë keni qëndruar? Një natë?

2 PË. Jo, më shumë. Nga dikun dy javë. Kam ardhë një herë deri
3 këtu, jam kthy, i kam marrë ushtarët edhe jam shku për në
4 Kleçkë, Krojmir. Dikun dy javë ka zgjatë ky proces.

5 PY. Në bazë të këtij takimi i keni thënë ZPS-së, do t'ua
6 lexoj pyetjen, përgjigjen, "keni menduar që Rexhep Selimi ka
7 qenë përgjegjës për UÇK-në në Kosovë në atë kohë". i qëndroni
8 ene kësaj?

9 PË. I qëndroj se ashtu kam mendu atëherë.

10 PY. Keni menduar atëherë, po as ta kanë thënë, as nuk keni
11 pas ndonjë informacion të drejtpërdrejt për këtë. Këtë e keni
12 bazuar ju në përshtypjen që keni krijuar pasi e keni takuar
13 kur ju dërgoj Azem Syla, kështu?

14 PË. Po atëherë ka qenë rregull ashtu që, ju thashë edhe më
15 herët, vetë s'ke mujt me hy, po përmes përfaqësuesve tonë që
16 na kanë përfaqësu. Unë mu ka dashtë me bë leje, kërkesë nga
17 Aargau për me hy në Kosovë në luftë. Mu ka pranë kërkesa, kam
18 ardhë në Tiranë, nga Tirana në Likovc, nga Likovci në Kleçkë
19 dhe nga Kleçka jam vendos në Krojmir. Kështu ka qenë. Nuk ka
20 qenë që van si me ardhë kush don. Ka pas rregulla.

21 PY. Po. Këtë e kuptojmë që ka pasur rregulla.

22 PË. Po.

23 PY. Por pyetjen e kisha këtu, kjo përshtypja juaj apo
24 përfundimi juaj apo supozimi juaj, se ai paska qenë përgjegjës
25 për UÇK-në në Kosovë, është bazuar, pran ju bazuat këtë

1 përshtypje në atë takim të shkurtër, kështu? Me po ose me jo
2 mund t'i përgjigjeni.

3 PË. Normal që po. Jo takimi i shkurt se kam ardhë me letër,
4 me dokument kam ardhë aty.

5 PY. Në rregull. Që të jemi të qartë, lidhur me dijeninë tuaj,
6 pra, lidhur me ato që dinit ju më saktë për gjërat në Kosovë
7 në atë kohë, keni shkuar ju në zona të tjera, për shembull, në
8 zonën e Dukagjinit apo në zonën e Llapit --

9 PË. Jo.

10 PY. -- apo në zona të tjera në atë pikë?

11 PË. Jo, asnjëherë.

12 PY. As nuk u takuat, as nuk morët, as nuk e dinit kush mund
13 të ishin udhëheqësit e tjerë të UÇK-së në atë pikë, apo jo?

14 PË. Nuk e kam dit. Se ju thashë më herët, se unë kam shërby
15 deri në brigadë. Brigadës i kam raportu. Ma lart jo.

16 Asnjëherë.

17 PY. Po. Unë po përpiqem të dal këtu, ju nuk e dini ose më
18 saktë, nuk keni ndonjë provë lidhur me autoritetin e z. Selimi
19 apo lidhur me persona të tjerë që nuk ishin pjesë e Likovcit,
20 bazuar në këtë takim të shkurtër që patët me të?

21 PË. Në atë kohë jo, s'kam dit.

22 PY. Atëherë unë po ju them bazuar në këtë që ju nuk keni
23 asnjë provë që ai ishte udhëheqës i UÇK-së në Kosovë për gjithë
24 Kosovën. E pranoni këtë që them?

25 PË. Ju, unë e kam thënë atë në fillim qysh kam ardhë. Edhe

1 atë mbaj përgjegjësi. Ça kam thënë kur kam hy ma shumë ma
2 vonë, nuk kam pasur dijeni. Nuk kam nejt, nuk e kam taku
3 asnjëherë. Çka do të them tjetër? Për gjena tjera flasin të
4 tjerët, jo unë.

5 PY. Përpara se të shkonit në Kosovë, a kishit dëgjuar
6 ndonjëherë për të për shkak të marrëdhënies së tij me Adem
7 Jasharin apo për faktorë të tjerë? Nga shtypi e kishe dëgjuar
8 ndonjëherë emrin Rexhep Selimi ju?

9 PË. Nuk kam lexu fort shtyp. S'kam çka të them. Nuk, s'kam
10 përgjigje. S'di çka të them.

11 PY. Pra, s'e kishit dëgjuar ndonjëherë emrin e tij, nuk e
12 dinit nëse kishte akuza të ngritura kundër tij apo ishte i
13 njohur në Kosovë ky?

14 PË. Unë s'mbaj mend. Është edhe kohë e gjatë. Nuk mbaj mend
15 se kam dëgju diçka për të. Janë nëpër gazeta mund t'i lexoni
16 nëse ka pas diçka.

17 PY. Në dëshminë tuaj keni thënë që vazhduat rrugën me z.
18 Limaj për të shkuar në Kleçkë?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe më pas në Krojmir?

21 PË. Po.

22 PY. ZPS-së i keni thënë që z. Selimi të ka thënë që "Duhet të
23 më raportosh mua, të më thuash mua sa ushtarë ke dhe çfarë
24 bëjnë".

25 PË. Shumë e vërtet.

1 PY. A të kujtohet?

2 PË. Shumë e vërtet. Më kujtohet mirë. Po unë asnjëherë s'i
3 kam raportu sepse jemi marrë vesh me Fatmir Limën që unë t'i
4 raportoju Fatmiri, Fatmiri i raporton Rexhep Selimit. A i ka
5 raportu, a s'i ka raportu nuk muj me dit. A unë që nga
6 atëherë, shembull, nga fillimi kemi raportu sa ushtarë janë
7 lajmëru, sa ushtarë ke, numrin e ushtarëve, shëndeti i
8 ushtarëve, të gjitha. Por unë jo Rexhep Selimit, i kam raportu
9 Fatmir Limës. Ashtu qysh kam thënë atëherë, ashtu qëndron.

10 PY. Po. Siç e thatë, në fakt asnjëherë nuk i raportuat Rexhep
11 Selimit dhe ju nuk e dini nëse i ka raportuar ndonjëherë
12 Fatmir Limaj --

13 PË. E saktë.

14 PY. -- ndonjë prej gjërave që i kishe thënë ti Rexhep
15 Selimit?

16 Dhe Krojmira është larg Likovcit? Sa zgjati udhëtimi juaj
17 nga Likovci në Krojmir?

18 PË. S'më kujtohet sa ka zgjatë por qashtu është larg shumë.

19 PY. Kështu që normalisht ju nuk do e kishit pasur të mundur
20 t'i raportoni direkt z. Selimi, apo jo?

21 PË. Ju thashë se s'i kam raportu asnjëherë. Unë kam raportu
22 te Fatmir Limaj. Asnjëherë s'i kam raportu Rexhep Selimi edhe
23 s'e kam pa.

24 PY. Po. Po, po të thoja që s'do kishte qenë as e lehtë t'i
25 raportoje --

- 1 PË. Jo, s' ishte.
- 2 PY. -- në këtë kushte --
- 3 PË. Normal.
- 4 PY. -- për shkak të largësisë?
- 5 PË. Në fillim i kam raportu edhe Shukri Bujës, në fillim,
6 fillim dhe ai Fatmirit. Kështu që unë jam marrë ma shumë me
7 përgatitjen e trashëve atje, bukërave për luftë. Edhe ka qenë
8 e pamundur. Dhe, domethënë, tash Fatmiri ka pas një pozitë ë
9 të madhe se unë dhe ai ka mujt me raportu. A i ka raportu a
10 s' i ka raportu nuk muj me dit, as më intereson. Unë i kam
11 raportu atij, Rexhës asnjëherë.
- 12 PY. Kuptova. Ju e konfirmuat që s' keni pasur telefon
13 satelitor, apo jo?
- 14 PË. As telefon, as radiolidhje s' kam pas asnjëherë gjatë
15 luftës. Përveç në luftës së Koshares.
- 16 PY. E përfunduat përgjigjen apo doni të shtoni diçka?
- 17 PË. Jo, jo e përfundova.
- 18 PY. Pra, do të kishte qenë e pamundur për ju që t' i
19 raportonit edhe sikur të donit, kur them "atij" e kam fjalën
20 për z. Selimi që ishte në Likoc?
- 21 PË. Ju thashë edhe një herë dhe besoj s' ke nevojë me çu më
22 gjatë se asnjëherë s' i kam raportu, as kisha mujt me raportu
23 edhe nuk kam qenë në pozitë unë me i raportu Rexhep Selimit.
- 24 PY. Kur i thatë z. Limaj se do t' i raportonit atij, ju nuk e
25 pyetët z. Selimi a ishte ai dakord me këtë, apo jo?

1 PË. Jo, jo s'e ka pyet askush.

2 PY. Pra, faktikisht ju nuk e respektuat ose më saktë e
3 shpërfillët atë që ju kishte thënë z. Selimi?

4 PË. Ne, ndëgjo, unë e kam dit se Fatmiri është më i madh.
5 Edhe ka thënë që "Unë tash kam punë me Likovc. Ti s'ke punë.
6 Ti më raporton mu, unë Likovcit". Origjinal kështu ka qenë.
7 Edhe s'ka pas nevojë më. Unë i kam raportu atij, kam besu që
8 ai është më i madh dhe raporton dikun atje ku duhet. E
9 kuptove?

10 PY. Dhe në atë kohë Fatmir Limaj ishte përgjegjës për
11 njësitet në Kleçkë?

12 PË. Po.

13 PY. Po, në fakt, ai ishte atje për të ndryshuar udhëzimin që
14 ju kishte dhënë personi më i pushtetshëm i UÇK-së në Kosovë?

15 PË. Nuk jam tuj e thënë për të ndryshu, po unë nuk e di për
16 çka ka qenë ai. Unë i kam raportu atij.

17 PY. Thatë se i keni raportuar z. Limaj kur ishit në Krojmir.

18 PË. Edhe Shukri Bujës edhe Limës. Të dyve.

19 PY. Shukri Bujës, po. Në këto takimet, në këto mbledhje të
20 rregullta, i thatë ZPS-së në mënyrë të qartë se nuk është
21 përmendur asnjëherë ndonjë burg në Kleçkë, në këto mbledhje
22 s'është përmendur ndonjëherë ndonjë burg në Kleçkë?

23 PË. Asnjëherë. Asnjëherë.

24 PY. Dhe ju e keni mësuar këtë gjë shumë kohë pas luftës,
25 kështu?

1 PË. Shumë e vërtet.

2 PY. Pra, gjatë gjithë kohës që keni qenë në Kleçkë dhe keni
3 vizituar Kleçkën rregullisht, as keni parë burg dhe as nuk
4 keni ditur që paska pasur burg në atë vend?

5 PË. Unë s'e kam -- vetëm në mbledhje kam shku në Kleçkë,
6 mbledhje javore. Edhe asnjëherë s'ka -- çfarë burgi? S'u fol
7 për burg kurrë, hiç. Vetëm pas lufte.

8 PY. Dhe vetë me sytë e tu s'ke parë ndonjë burg kur keni qenë
9 në Kleçkë?

10 PË. Po çfarë burgu ore? S'është.

11 PY. Po meqë të pyetën a e ke ditur këtë gjë. Unë dua të jem i
12 qartë. Dhe po ju them duke qenë se shkoje rregullisht në
13 Kleçkë, vetë ti nuk pe ndonjë burg me sytë e tu?

14 PË. Ju thashë një herë në javë kam shku në mbledhje edhe nuk
15 kam pa burg. Burgi për Kleçkë u ndigju mbas luftës.

16 PY. Faleminderit.

17 PË. Po. Edhe s'kemi të bëjmë ne me atë burg. Dijet a qartë
18 kush.

19 PY. Dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me ato që dini për
20 Shtabin e Përgjithshëm dhe lidhjen që kishit ju me Shtabin e
21 Përgjithshëm. I keni thënë ZPS-së që nuk e keni ditur se cili
22 ka qenë dallimi mes qendrës dhe shtabit qendror, kështu?

23 PË. Gabim e ke. Në fillim kena mendu se u quajt Shtab Qendror
24 mbasandaj Shtab i Përgjithshëm. Këtu është sigurisht, e ke
25 gabim aty.

1 PY. I keni thënë ZPS-së, kjo është në Pjesën 8, faqja 4 --

2 PË. Po, po.

3 PY. -- ose prova materiale P1115.8

4 "PY. Ça dallimi është mes Shtabit Qendror dhe Shtabit të
5 Përgjithshëm?"

6 Ju i jeni përgjigjur:

7 "Nuk e di".

8 PË. Nuk e di, s'e kam dit.

9 PY. Ju nuk jeni informuar ndonjëherë kush ka qenë në Shtabin
10 e Përgjithshëm, apo jo?

11 PË. Jo.

12 PY. Nuk keni qenë ndonjëherë në ndonjë mbledhje me Shtabin e
13 Përgjithshëm dhe as nuk keni qenë pjesëtar i Shtabit të
14 Përgjithshëm siç i thatë ZPS-së?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I keni bërë
16 dy pyetje në një.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do t'i zbërthej.

18 Unë në fakt po citoja pyetjet siç i ka bërë Prokurorja
19 gjatë intervistës. Kështu që më saktë po lexoj intervistën.

20 PY. Dëshmitar, në intervistën për ZPS-në, që është me numër
21 P1115.2, faqja 12:

22 "PY. A keni marrë pjesë ndonjëherë në mbledhje apo
23 urdhëresat që jepeshin nga Shtabi i Përgjithshëm në Likoc?

24 "PË. Jo, asnjëherë nuk kam qenë në mbledhje të Shtabit
25 të Përgjithshëm dhe nuk kam qenë anëtar i Shtabit të

1 Përgjithshëm".

2 Kështu, Dëshmitar?

3 PË. Ashtu. Të gjitha ato që shkruhen aty janë të sakta,
4 domethënë, nuk kam çka i kontestoj. Të gjitha që i kam thënë.

5 PY. As nuk keni pasur kontakte me Shtabin e Përgjithshëm edhe
6 keni shkuar veç nja dy herë kur u zhvendos në Divjakë, që i
7 bie rreth fundit të 1998, kështu?

8 PË. Shumë e vërtetë është.

9 PY. Divjaka është afër Kleçkës, ama është zonë e ndarë, apo
10 jo?

11 PË. Afër Kleçkës, ngjit aty me Kleçkën.

12 PY. Janë ngjitur, por është vend më vete, janë të ndara?

13 PË. Po normal se këndeje ka Shtabi i Përgjithshëm andej ka
14 qenë brigada. Vetëm q'ashtu në qoftë se e kërkon.

15 PY. Siç i thatë ZPS-së, deri në fund të 1998 ishte shumë e
16 vështirë të komunikoje me Shtabin e Përgjithshëm edhe ky
17 komunikim u përmirësua vetëm kur shkuan në Divjakë. Ju
18 kujtohet që ia keni thënë këtë ZPS-së?

19 PË. Mund t'ia kem thënë. S'po më kujtohet, po sigurisht mbasi
20 shkruan aty e kam thënë, në rast se shkruan.

21 PY. Dhe kjo ka qenë përafërsisht në kohën kur shkuat në
22 Shqipëri, se besoj që ju jeni larguar drejt Shqipërisë nga
23 fillimi ose mesi i janarit, apo jo?

24 PË. Mesi i janarit.

25 PY. Pra, përmirësimet që kanë ndodhur në komunikimin me

1 Shtabin e Përgjithshëm kanë ndodhur atëherë gjatë kohës kur
2 nuk ishe më në Shqipëri, pasi kishe kaluar në Shqipëri, apo
3 jo?

4 PË. Edhe një herë? Si thua komunikim?

5 PY. ZPS-ja të ka pyetur lidhur me komunikimin me Shtabin e
6 Përgjithshëm. Dhe në intervistën që ke dhënë P1115.3, faqja
7 13, thatë:

8 "... në fund të vitit 1998 kur shkuan në Divjakë ishte
9 shumë më e lehtë që të kontaktoje me ta, të komunikojë me ta".

10 Dhe ajo që po them unë është, që ky përmirësim në
11 komunikimin me Shtabin e Përgjithshëm ka ndodhur në atë
12 periudhë kohore kur ti po shkoje në Shqipëri, a nuk është
13 kështu?

14 PË. Atëherë unë e kam marrë një leje nga Zyrapit për me shku
15 në Shqipëri, domethënë, me urdhër të Bislime Zyrapit, shefit të
16 Shtabit të Përgjithshëm edhe të komandantit të brigadës Haxhi
17 Shalës, kam shku për Shqipëri. Edhe unë ju thashë edhe më
18 herët, se s'kam pas unë pse me komunikim me Shtab të
19 Përgjithshëm kur kam qenë komandant batalioni. Vetëm kur e kam
20 marrë këtë udhëzimin për me shku në Shqipëri e kam marrë prej
21 tyne, përndryshe s'di.

22 PY. Pra, nuk ke njohuri personale nëse janë përmirësuar këto
23 komunikime pra, pasi nuk ke patur nevojë vetë që të komunikosh
24 vetë me Shtabin e Përgjithshëm, a nuk është kështu?

25 PË. Jam tu u thënë disa herë, që normal unë s'kam pas

1 mundësime komuniku me Shtab të Përgjithshëm. S'mu ka dhënë
2 mundësia. As kam njohuri.
3 PY. Pra, kur thoni që janë përmirësuar komunikimet, unë po ju
4 them që ti nuk ke njohuri të drejtpërdrejta. Po përpiqem të
5 kuptoj se mbi çfarë baze ke thënë që janë përmirësuar
6 komunikimet?

7 PË. Unë s'kam komunikuar asnjëherë me ta. Kush e di qysh ka
8 ngelë kjo "komunikimi" fjala. Mirëpo unë s'kam komuniku. As i
9 kam njoft të gjithë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, s'ia
10 kam ditë pozitativ kush çka ka pas. E kemi dit që Azem Syla
11 është shefi ai komandant i përgjithshëm. Kjo është.

12 PY. Faleminderit. Atëhere për sa u përket të ashtuquajturve
13 urdhra që gjoja i ka nxjerrë Shtabi i Përgjithshëm, i keni
14 thënë ZPS-së që z. Limaj nxirrte urdhra në emër të Shtabit të
15 Përgjithshëm kur ishte komandant brigade, por se ti nuk ishe
16 në gjendje të kujtoje asnjë urdhër të posaçëm, të veçantë. A
17 të kujtohet që i ke thënë këtë ZPS-së?

18 PË. Më kujtohet. Po, e kam thënë. Shpeshherë në mbledhje ka
19 thënë "në emër të Shtabit të Përgjithshëm" dhe kam thënë tash
20 ku e di a si ka qenë, kam dyshu, a në emër të Shtabit të
21 Përgjithshëm a e ka bërë vetë në vete. Kryesorja ashtu qysh kam
22 thënë.

23 PY. Pikërisht për këtë ja i interesuar. Ti ke i ke marrë
24 urdhrat apo udhëzimet nga komandanti i brigadës dhe jo në
25 mënyrë të drejtpërdrejt nga Shtabi i Përgjithshëm, kështu që

1 nuk ke pasur mënyrë për ta ditur nëse vërtet këto urdhra ishin
2 lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm, apo jo?

3 PË. Shumë e saktë.

4 PY. Dhe nuk e ke parë z. Limaj duke biseduar me Shtabin e
5 Përgjithshëm, kështu që ti nuk e dije nëse këto urdhra do të
6 kenë ardhur nga Shtabi i Përgjithshëm. Këtë i ke thënë ZPS-së.

7 PË. S'ke pas mundësi me pa. Ka qenë kohë lufte. Ashtu është
8 qysh kam thënë.

9 PY. Të thuash që urdhrat kanë ardhur nga Shtabi i
10 Përgjithshëm do të ishte një mënyrë që ato të tregoheshin që
11 ata ishin njerëz të rëndësishëm dhe që kishin autoritet më të
12 madh, apo jo?

13 PË. Sigurisht.

14 PY. Dhe, në fakt, ti i ke thënë ZPS-së që mendoje që z. Limaj
15 thoshte që urdhrat vinin nga Shtabi i Përgjithshëm me qëllim
16 që urdhrat apo udhëzimet e tij të dukeshin se ishin më të
17 rëndësishme, a është kështu?

18 PË. Më të fuqishme. Kështu është mendim i jemi. I kam mendu
19 ato.

20 PY. Po ti mendove të njëjtën gjë edhe për Shukri Bujën kur ai
21 në fund të korrikut dha urdhër që të tërhiqje trupat nga
22 Linaja? Ju kërkoi ndjesë për shqiptimin.

23 PË. Nga Blinaja, nga komplet, ka dhënë urdhër që me u tërhhjek
24 luftëtarët e batalionit, domethënë, me u tërhhjek nga zonat
25 edhe --

1 PY. Dhe ai ty të tha që ky urdhër kishte ardhur nga Shtabi

2 Përgjithshëm?

3 PË. Mbasi i ka tërhjek, kur e kam taku dhe e kam pyet "Kush e

4 bëri këtë?" Thotë "E zbatova urdhrin e Shtabit të

5 Përgjithshëm". Kështu ka thënë atëherë në atë kohë para

6 ushtarëve. Edhe këtu s'besoj s i ka thënë Shtabi i

7 Përgjithshëm që e ka dhënë atë urdhër.

8 PY. Pra, këtë i the Tribunalit të Hagës, që ti nuk mendove që

9 ky urdhër kishte ardhë nga Shtabi i Përgjithshëm. Dhe më vonë,

10 ty të kanë treguar nga Shtabi i Përgjithshëm që në fakt që ata

11 nuk e kishin nxjerrë këtë urdhër, a është kështu?

12 PË. Pas një takimi kur kanë ardhë te na, kanë thanë që "S'e

13 kena bë". Qysh s'e kena ba? Ata mu s'më kanë dhënë

14 përgjegjësi, por e kemi kuptu që e ka bë kokë më vete Shukri

15 Buja

16 PY. Megjithatë, pavarësisht se mendove që ky ishte urdhër që

17 vinte nga Shtabi i Përgjithshëm, përsëri ti mendove që mund ta

18 injoroje, të mos e zbatoje këtë urdhër të Shukri Bujës, apo

19 jo?

20 PË. Jo, ne s'kishim ku shkojmë në atë kohë. S'kishim ka

21 shkonim. Nuk kishim sepse ishim të armatosë. S'kishim ku të

22 shkojmë. Edhe, domethënë, mbasi jemi tërhejek jemi bashkë

23 prapë ushtarët edhe jemi dalë napër pozicione. Se s'kishim ku

24 të shkojmë.

25 PY. Nuk po përpiqem të them këtu në se ti kishe të drejtë apo

1 kishe gabuar mënyrën si veproje, por pika apo çështja që po
2 ngre është që Shukri Buja të ka dhënë një urdhër, gjoja në
3 emër të Shtabit të Përgjithshëm dhe ti si komandant batalioni
4 mendove se mund edhe të mos e zbatosh?

5 PË. Ju lutem. Gabim e ke pyetjen. Ju ka thënë ushtarëve në
6 front "Tërhiqu". "Tërhiqu. Mbanja ka doni se s'ka më UÇK".
7 Pastaj ne jemi bë bashkë ushtarët edhe kemi vendosë mos me ik
8 po me -- kena ngel. Ai është moment. Kena ngel në front. Kur
9 ka ardhë ky i kam thënë "Kush e bëri këtë?" Thotë "E zbatova
10 urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm" edhe ka hecun. Na kena ngel
11 në rrugë. Jo që -- ne s'kena pas ka me shkue. S'ka pas më
12 urdhra aty. Është luftë. Ti s'mund me kuptu qysh është gjendje
13 lufte. Edhe kemi mbet aty. Kemi mbet vetëm. Mbasandej kanë
14 ardhun për një kohë shumë të shkurt shumë shpejt kanë ardhë
15 ata shokë që i kam përmend unë. E kanë mbajt një takim. Kanë
16 thënë "Vazhdoni luftën. Është në rregull. Është kështu". Jo që
17 -- se unë s'kisha pas qarje me e zbatu urdhrin. Po aty ka qenë
18 luftë dhe kemi ngel të shpërndamë. Kemi ngel keq. Nuk muj --
19 po.

20 PY. Unë nuk po përpiqem që të fajësojë këtu. Thjesht po
21 përpiqem të kuptoj si kanë rrjedhur ngjarjet. Pra, në atë kohë
22 Shukri Buja të tha që ky ishte një Urdhër i Shtabit të
23 Përgjithshëm por që ti vazhdove dhe nuk e zbatove në atë pikë.
24 A nuk është kështu?

25 PË. Nuk është. Jo.

1 PY. Unë nuk e kam fjalën vetëm për ty. E kam fjalën ti dhe
2 ushtarët e tjerë.

3 PË. Nuk është ashtu. Na kena ngelë në rrugë. Na kena ngelë
4 sikur meqë thuja në atë moment pa komandë. Pa komandë sikur me
5 qenë. Na s'kena pas ku me shkue se kemi ngel për një kohë të
6 caktume atëherë. Shumë shpejt derisa jemi bë bashkë prapë.
7 Kemi ngelë në atë moment thua një javë ditë pa komandë. Kemi
8 ngel në rrugë, sikur të them kështu zogjve kur nuk e kanë
9 pulën, ta them popullorçe, sikur zogjve ia merr një pulë
10 ngelin ata ka kanë me shku, kush ku të mundet. Edhe kështu
11 kemi ngelë në atëkohë. Mirëpo shumë shpejt --

12 PY. Po ti thua që në atë moment nuk kishte më strukturë
13 komanduese mbi nivelin tënd, po thua që në atë fazë nuk kishte
14 më komandë?

15 PË. Jo. Dy javë ditë kena ngelë se jena shpërnda, kena ngelë
16 vetëm. Ka ngelë Shukria dikund tjetër. Fatmiri dikun. Unë kam
17 ngelë me ata ushtarë. Mbrenda një jave dy, jena bashku prapë.
18 Këtë po e them. Edhe ndodhë ajo në luftë.

19 PY. A mendon që ka pasur edhe urdhra të tjera të cilat të
20 jenë lëshuar nga Fatmir Limaj apo Shukri Buja të cilat mendon
21 se nuk ishin urdhra të Shtabit të Përgjithshëm por që juve ju
22 kanë thënë që këto ishin urdhra të Shtabit të Përgjithshëm?

23 PË. Nuk ka pa. Këto çka i përmenda unë. Shkonim ndonjëherë në
24 mbledhje kur ka desht me bë ma të fuqishmit, thashë ma herët,
25 ka pas rast kur e ka përmend Fatmiri, sigurisht me kanë ma i

1 fuqishmi me i besu na më shumë a ku ta di unë. Është mendimi i
2 tina. Mundet me i marrë me veta ato, përndryshe hierarkia ka
3 qenë shumë në rregull batalion-brigadë.

4 PY. Flasim për batalionin tënd atëherë, pasi është e
5 rëndësishme kjo edhe në kuadrin e një pyetjeje që të ka bërë
6 Prokuroria pasi the që ti je në gjendje që të flasësh vetëm
7 për batalionin ku ke bërë pjesë. E pranon një gjë të tillë,
8 apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Për sa i përket hierarkisë, mënyrës së funksionimit. Ti
11 mund të flasësh vetëm për batalionin tënd, apo jo?

12 PË. Po

13 PY. Sa ishte numri i personave që ishin pjesë e batalionit
14 tënd në maj, në qershor, në qoftë se vërtetë në atë kohë ishte
15 formacion si batalion?

16 PË. I ke të shkruar të gjitha aty. I ke shkruar në proces.

17 PY. Njësitit më duhet të them.

18 PË. I ke të shkruar në proces. Unë për shkak s'kam dëshirë me
19 bë ndonjë gabim, mos me - se është një kohë shumë e gjatë, po
20 i ke aty të shkruar qysh i kam dhanë. Muj me i lexue. I kam
21 dhënë krejt shkrimet atje.

22 PY. Dua të jemi në gjendje që të kuptojmë se deri në çfarë
23 mase mund të flasësh këtu. Kur flet për lejet që ke lëshuar,
24 për shembull.

25 PË. Po.

1 PY. Apo rregulloren lidhur me jetën e brendshme të ushtrisë e
2 kështu me radhë. Ajo që ke kuptuar ti se ka funksionuar kjo
3 punë brenda batalionit apo njësitit tënd dhe ti nuk dëshiron
4 të flasësh për atë që mund të ketë ndodhur tjetërkund?

5 PË. Po siç qysh ka ndodhë te unë, ka ndodhë dhe në batalione
6 tjerë. Unë s'kam qenë i veçantë prej tjerëve. Të njëjtën kemi
7 qenë. Qysh ka qenë te unë ka qenë edhe te batalioni tjetër.
8 Shembull, sikur ai që e ka lëshuar atë lejen. U dashtë me pas
9 lejen me shku ushtari deri në brigadë, leje qarkullimi. Për sa
10 kohë, shembull, për katër orë, për katër orë u dasht me ia
11 lëshu. Kanë qenë lëvizjet e kontrollume si me qenë një ushtri
12 e rregullt. Nuk e kam bërë vetëm unë. Të katër batalionet e kanë
13 pas ashtu. Po unë kam fol për batalionin tem, për punën teme.

14 PY. Por ti ke njohuri personale për ato që kanë ndodhur në
15 batalionin tënd. Dhe mendon që e njëjta gjë ka ndodhur edhe në
16 batalionet e tjera por se nuk ke njohuri të drejtpërdrejt --

17 PË. Normal që --

18 PY. -- për atë që ka ndodhur në batalionet e tjera, a nuk
19 kam të drejtë që ta them këtë?

20 PË. Normal që s'kam njohuri.

21 PY. Më fal, që të ndërpreva, The:

22 "Nuk kam njohuri për ..."

23 A do ta plotësosh përgjigjen?

24 PË. S'kam për batalionet të tjera thashë.

25 PY. Apo më lart në nivel në zinxhirin komandues, për

1 shembull, sa i përket brigadave edhe sigurisht edhe për zonat
2 e tjera nuk ke njohuri? E pranon një gjë të tillë, apo jo?

3 PË. S'kam njohuri.

4 PY. Dhe, në fakt edhe për lejet, më duket që ti the sesi
5 komandant batalioni ke patur një mënyrë më të rreptë të
6 zbatimit duke thënë që nuk i ke lejuar njerëzit që të
7 udhëtonin gjatë natës. A të kujtohet një gjë e tillë?

8 PË. Për shkak të sigurisë. Shumë e vërtetë. Për shkak të
9 sigurisë, domethënë, e kena bë ne që natën me pas një kontroll
10 ndryshe që mos me hi dikush, domethënë, me pas nën kontroll që
11 mos me të hi armiku apo dikush tjetër në atë zonën ku e kemi
12 kontrollu ne, ku e ka pas batalioni. Shumë e vërtetë. Për
13 shkak se kam desht me pas lëvizjen në kontroll, lëvizjen e
14 njerëzve.

15 PY. Dhe besoj se ke thënë që z. Limaj të ka kritikuar për
16 zbatimin e kësaj rregulle por nuk të ka urdhëruar që ta
17 ndalosh apo ta ndryshosh, apo jo?

18 PË. Jo, Fatmiri, domethënë, ka pas dëshirë që gjithmonë ai të
19 duket aty edhe më i madh siç ka qenë dhe i ka bë këto për me u
20 duk ma interesant nëpër mbledhje se është dikushi. Edhe normal
21 unë u dasht me i zbatu urdhrat e tina.

22 PY. Ti thua që duhet t'i zbatohet urdhrat, por nuk i ke
23 treguar ZPS-së në mënyrë të veçantë lidhur me një urdhër të z.
24 Limaj të cilin ti nuk e ke zbatuar?

25 PË. Cilin, shembull?

1 PY. Në intervistën me ZPS-në.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] P1115.2, faqja 44.

3 PY. Dhe më lejoni ta lexoj këtë shkëmbim që është bërë.

4 Pyetje nga ZPS-ja lidhur me z. Limaj:

5 "A ishte ky urdhër që të shkoje për të fshehur uniformën
6 dhe armët?"

7 Dhe përgjigje:

8 "Ia dha urdhrin Batalionit të Parë, unë e kundërshtova
9 dhe unë u thashë 'Vendosni, vishni uniformat dhe merrni
10 armët'. Në batalionin tonë ne e kemi shkelur këtë urdhër".

11 Prisni sa të mbaroj.

12 "Ne nuk i kemi fshehur armët dhe uniformat.

13 "PY. A ishte ky ishte -- a ishte uniformë a ishte urdhri
14 i cili kishte të bënte dhe me batalionin tënd?

15 "PË. Sigurisht. Po, sepse ai ishte komandant i
16 brigadës".

17 Pra, në këtë rast ti po përshkruan sesi z. Limaj ka
18 nxjerrë një urdhër të veçantë të cilin ti si komandant
19 batalioni ti ke vendosur që të mos e zbatosh, a nuk është e
20 saktë?

21 PË. Ndëgjo. Ky ka qenë ofensiva e dytë. Kur në një zonë tek
22 kompania e parë në Shalë, Fatmir Limaj ju kish pas thënë, e
23 kanë raportu ushtarët. Unë s'e kam dëgjuar. Ju ka thënë që
24 "t'i mshefin uniformat edhe pushkë se po na pret Kryqi i Kuq.
25 Dilni dorëzonu". Edhe pastaj unë kam kërku nga ushtarët kam

1 thënë se "Qysh me u dorëzu". Është i vetmi rast që kam thënë
2 të luftojna deri në fund aq sa të mbesmi. I vetmi rast është
3 që, domethënë, unë edhe pse mu direkt s'më ka thënë ai po ju
4 kam thënë ushtarëve po luftojna deri në fund. I ka ardhë sikur
5 nuk është zbatu qa ai urdhër.

6 Po mbrena një muaji prapë është, një muaj a dy javë, ku e
7 di unë, prapë Fatmiri vjen si komandant brigade prapë, e
8 vazhdojmë jetën prapë. Prapë u dashtë me ndëgjju, me e
9 respektue. Kjo është.

10 Tash unë nuk e di çka po të hyn në punë, pse që atëherë
11 një rast paska qenë, kjo ka qenë në luftë, domethënë, sikur me
12 më thënë mue hajde mshoi kokës prej muri, me të tha hajt kokës
13 për muri me të thanë ty dikush, unë besoj që nuk e ngon? Kjo
14 ka qenë ashtu: Hajde mshifni armët dhe uniformat. Domethënë, i
15 vetmi rast është. S'di çka.

16 PY. Në fakt, nuk është i vetmi rast. Pasi ishte dhe i rasti i
17 Shukri Bujës të cilin e diskutuam më lartë.

18 Por ajo që po them unë këtu është që ti ke kundërshtuar
19 një urdhër i cili do të duhej të ndiqej -- dhe prisni derisa
20 të përfundoj pyetjen.

21 PË. Po.

22 PY. Dhe për arsye legjitime ti mendove që nuk kishe nevojë
23 për ta zbatuar këtë urdhër. Dhe përgjigja është thjesht "po"
24 apo "jo". Unë e kuptoj shpjegimin tënd. Por ti nuk e ndjeje që
25 nuk kishte nevojë që të ndiqje një urdhër për të hequr armët

1 dhe uniformat, apo jo?

2 PË. Ai urdhër është dashtë së paku të jetë ndoshta dhe me
3 shkrim edhe ne kena, ka qenë në front. Ka qenë në front edhe
4 na jena mbetun. Të kallëzova dhe prapë, nuk është po, jo. Po
5 duhet me ta shpjegu shumë mirë, se na kemi ngelë në front,
6 kena ngelë në pyll në atë kohë dhe u dashtë me luftue. S'ke
7 mujt ti me zbatu urdhrin me ik. Ku me shkue? Është kjo është
8 sikur pyetje qesharake ndoshta që bani ju mue, se përndryshe
9 nuk ka ndodhë një herë dhe mos me zbatu urdhrat e tyne.

10 PY. Po bëni një koment shumë interesant. Më falni që të
11 ndërpres.

12 Thatë që nuk ishit në gjendje që ta zbatoje këtë urdhër
13 dhe vërtetë kështu ka ndodhur? Në atë rast, nuk ishte e mundur
14 --

15 PË. S'ishte e --

16 PY. -- që të detyrohej zbatimi i urdhrave nga komandanti i
17 brigadës deri te një komandant batalioni.

18 Të lutem prit një çast derisa të mbaroj pyetjen time me
19 qëllim që të mund të regjistrohet përgjigja juaj.

20 Ti the që nuk ishit në gjendje që ta zbatoje këtë urdhër
21 dhe kështu ka ndodhur? Urdhri i një komandanti të brigadës si
22 z. Limaj nuk mund të zbatohej në atë fazë. A e pranon këtë?

23 PË. Për shkak të, domethënë, kohës ku ishim s'ke mujt me
24 zbatu. Se s'ke pas nga shkon. Se ke qenë në luftë. Përndryshe
25 s'ka ndodhë asnjëherë mos me i zbatu urdhrat e tina. I vetmi

1 ky rast është që s'ke mund jo që s'ke desht. Po nuk ke mund me
2 e zbatu atë urdhër. Se s'ke qysh me dal me na pri me dal te
3 forcat serbe ne me shku me ushtarë? Këtu është puna. Nuk ke
4 pas mundësi me e zbatu atë urdhër, jo që s'ke desht.

5 PY. Edhe në batalionin tënd e pranon që vetëm 80 për qind të
6 ushtarëve të kanë raportuar.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kjo është në intervistën tënde të
8 ZPS-së, P1115.7, faqja 7.

9 PY. Dhe po lexoj atë që keni thënë me qëllim që ta keni të
10 qartë:

11 "Unë nuk mund të isha askund por aty ku isha më
12 raportonin njerëzit që ishin aty. Ndoshta jo të gjithë më kanë
13 raportuar gjatë kohës por më kanë raportuar mjaft ... ndoshta
14 80 për qind të ushtarëve më kanë raportuar mua dhe unë i
15 raportoja më pas brigadës."

16 Pra, e pranoni që edhe brenda batalionit tënd -- prisni,
17 prisni sa të mbaroj. Në batalionin tënd që e konsideron se
18 ishte shumë i organizuar 20 për qind e ushtarëve të tu nuk të
19 raportonin ty drejtpërdrejt dhe nuk zbatonin urdhrat apo
20 udhëzimet që jepje ti. A nuk është kështu?

21 PË. Kam thënë që dikund 80 për qind kanë mujt me qenë në
22 kontroll. Ndërsa kanë mujt me qenë një 20 për qind që kanë
23 mujt me mshef mos me të raportu. Shumë e vërtetë është. Jo, që
24 s'më raportonin, po kanë mujt me më fshef se s'un i ke pas
25 krejt nën kontroll. Kështu e kam thënë në qoftë se e ke kuptu.

1 PY. Po thoni që nuk kishe mundësinë për t'i kontrolluar
2 njerëzit që ishin pjesë e batalionit tënd, kështu po thua?

3 PË. Po të gjithë s'ke mujt. Një 80 për qindsh ke mujt. 20 për
4 qind ka qenë luftë. Normal. Edhe po mos me qenë luftë krejt
5 shteti si shtet nuk mund i paske njerëzit nën kontroll dhe në
6 liri kur je.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
8 Pak më herët se sa çiksha planifikuar po kam arritur në fund
9 të pyetjeve që kisha.

10 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
12 Z. Misetiç, ju e keni fjalën.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

14 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç:

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, mirëdita.

17 PË. Mirëdita.

18 PY. Unë jam Luca Misetiç. Unë jam Avokati i z. Thaçi. Dhe kam
19 disa pyetje për të bërë.

20 Në dëshminë tënde, ke thënë që të kujtohet që ke takuar
21 z. Thaçi tre herë, në dy prej këtyre rasteve thatë që e keni
22 parë në Krojmir, kështu është?

23 PË. Po.

24 PY. Kur keni shkuar tek selia e UÇK-së në Divjakë nuk të
25 kujtohet që ta kesh parë atje z. Thaçi, apo jo?

- 1 PË. S'më kujtohet. Mund të ndodhë që e kam pa, po mu s'më
2 kujtohet. Dhe unë s'kam qenë atje në Divjakë shpesh. Kam qenë
3 veç për leje atëherë kur e kam marrë lejen me shku andej.
- 4 PY. Thatë që e ke takuar z. Thaçi në Krumë përpara se të hyje
5 në Kosovë, kështu është?
- 6 PË. Po.
- 7 PY. Para këtij takimi a ke ditur se kush ishte z. Thaçi?
- 8 PË. Jo.
- 9 PY. Në ç'mënyrë është paraqitur, si është paraqitur para teje
10 z. Thaçi?
- 11 PË. Për kur e ke fjalën?
- 12 PY. Në Krumë.
- 13 PË. Si i thjesht, si jo me naj farë pozite. S'kam ditë as që
14 ka pozitë as.
- 15 PY. Po atëherë si e dije që personi që e shihje ishte z.
16 Thaçi?
- 17 PË. Ne ishim në atë kohë t'u hy mbrenda, ishim t'u u përgatit
18 me hy mbrenda me Azem Sylën edhe aty jemi taku. Jemi taku
19 bashkë. E kuptum që është z. Thaçi. S'di qysh me të thanë.
20 S'di si ta shpjegoj. Jo ndonjë farë, i veçantë s'ka qenë. I
21 thjesht sikur na ushtarët tjerë.
- 22 PY. Thoni që e keni kuptuar që ishte z. Hashim Thaçi. Si e ke
23 kuptuar që ishte z. Hashim Thaçi?
- 24 PË. S'di si. Ka shku kohë e gjatë. S'di si të them, s'di si
25 ta shpjegoj. S'di si ta shpjegoj. Po dikush ka thënë aty, a e

1 ka thënë Azemi a dikush tjetër, po jo diçka të veçantë nuk ka
2 pas.

3 PY. Keni thënë po kështu që e keni takuar z. Thaçi gjatë
4 vizitës së Shtabit të Përgjithshëm në Krojmir për sa i përket
5 vendimit të Shukri Bujës për tërheqjen e trupave nga Beteja e
6 Llapushnikut, a është kështu?

7 PË. Atëhere kanë qenë. Mbasi ka dhënë këtë urdhër Shukria
8 mbasandaj kanë ardhë në Krojmir. Po.

9 PY. Një herë ka ndodhur nga fillimi i gushtit të 1998?

10 PË. Aty dikund. Nuk jam i saktë. Nuk e di saktë datën.

11 PY. Në intervistën me ZPS-në, në P1115.4, faqja 10 në
12 anglisht, rreshtat 16 deri në 25, thoni që:

13 "Ishte në Krojmir. Sigurt që ishte në gusht, në fillim të
14 gushtit.

15 "PY. Të 1998?

16 "PË. Po".

17 PË. 1998. Po.

18 PY. Dhe a i përmbaheni asaj që keni thënë kur keni thënë që
19 sigurt që ka qenë fillimi i gushtit?

20 PË. Datën e saktë nuk muj me dit, ndërsa në atë kohë dikun
21 kanë qenë. Nuk muj me dit datën e saktë se s'e kam shënuar.
22 Por që kanë qenë është shumë e saktë. Për datë nuk muj me të
23 thënë saktë.

24 PY. A të kujtohet që në atë kohë ishte gjendja e rëndë në
25 Krojmir për shkak të granatimeve serbe?

1 PË. Po, po.

2 PY. Pra, ishte koha e ofensivës serbe?

3 PË. Po.

4 PY. Në këtë takim me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
5 përfshirë z. Thaçi, nuk ishin të pranishëm as z. Shukri Buja,
6 as z. Fatmir Limaj --

7 PË. Jo.

8 PY. -- pra, në kohën kur mbaheshin këto diskutime, apo jo?

9 PË. Asnjëri.

10 PY. A e dini në fakt nëse ato kishin ardhur në Krojmir dhe
11 thjesht po kalonin përmes Krojmirit dhe kjo bëhej në kuadrin e
12 ofensivës së atëhershme?

13 Po e bëj ndryshe pyetjen. A more ndonjë ftesë apo urdhër
14 për të shkuar për t'u takuar me Shtabin e Përgjithshëm apo
15 ndodhi që u takove më të në Krojmir rastësisht?

16 PË. Jo, rastësisht këta kanë ardhë aty. Këta kanë ardhë. Jo,
17 unë s'kam shku te ta. As kam pas ftesë. Po këta kanë ardhë në
18 batalion, domethënë, në fshat ku e kam pas bazën.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që kemi probleme me
20 përkthimin këtu lidhur me përgjigjen e dëshmitarit.

21 PY. Dëshmitar, do t'ju pyes dhe një herë. Në shqip ju thatë
22 që ata kanë ardhur aksidentalisht, kështu thatë?

23 PË. Jo, nuk thashë aksidentalisht. Nuk e di pse kanë ardhë.

24 Po tash, mbasi kanë ardhë, tregoj bisedën çka u bisedu?

25 PY. Në rregull.

1 PË. Ju më pyetni. Çka di, do ta them.

2 PY. Unë pyetjen e kisha kështu. Ju nuk i prisnit ata. Nuk ju
3 tha njeri paraprakisht që do vijnë anëtarë të Shtabit të
4 Përgjithshëm --

5 PË. Jo re jo.

6 PY. -- që të takohen me ju?

7 PË. Jo, jo, jo.

8 PY. Besoj se thatë që ju kujtohet që në atë kohë personi
9 kryesor i UÇK-së ka qenë Azem Syla, kështu?

10 PË. Po. Ashtu u ndigju.

11 PY. Dhe hera e tretë ka qenë ai takimi ku ju dhe z. Thaçi,
12 thoni ju pra, jeni takuar me një gazetar të *New York Times* me
13 emrin Mike O'Conner, kështu?

14 PË. Mike O'Connor, qysh quhet. Po, jena taku. Po më duket a
15 para kësaj a mbas kësaj, këtij takimit. Nuk jam i sigurt. Ne
16 kemi dhënë intervistë bashkë, është ajo intervista në gazetë
17 edhe pse s'un e kam gjet. Po e kemi dhënë intervistë bashkë në
18 odën time aty ku e kam pas komandën e batalionit.

19 PY. Ju thatë "nuk jam i sigurt e kam takuar para apo pas
20 takimit". Për kë e keni fjalën?

21 PË. Për z. Hashim Thaçi.

22 PY. Nuk jeni i sigurt a e keni takuar z. Thaçi përpara
23 takimit me Mike O'Connor po thoni?

24 PË. Jo, jo, jo. Gabim e ke. E ke marrë gabim. Nuk e di ky
25 takim a ka qenë para se kur kanë ardhë këta komplet me grup a

1 ma herët a ma vonë. Këtë e thashë. Këtë deshta ta them.

2 PY. Në këtë takim me Mike O'Connor me sa kuptonit ju, me sa
3 dinit ju z. Thaçi ishte personi që merrej me shtypin në atë
4 kohë në UÇK?

5 PË. Jo, re. Jo. Pse po më pyet ashtu?

6 PY. Nuk thashë që e keni thënë. Po sipas jush, po sipas jush.
7 Kështu e dinit ju? Domethënë, sipas jush, roli i z. Thaçi në
8 UÇK ishte të merrej me shtypin, siç ishte dhe rasti me *New*
9 *York Times*?

10 PË. Të them të singertën unë nuk e kam dit pozitën e Hashimit
11 në atë kohë, po e kam ditë që është më i madh se unë po, e më
12 i madh, domethënë, edhe jo, s'e kam dit për gazetar. Po as
13 pozitën e tij s'e kam dit në atë kohë çka pozite ka pas.

14 PY. ZPS-ja gjatë intervistës të ka thënë se nuk ka ndonjë
15 procesverbal apo ndonjë dokumentacion të intervistës suaj me
16 *New York Times*. Dhe tani po vras mendjen, a kontrollove
17 ndonjëherë pas intervistës me ZPS-në ta gjejë këtë intervistë
18 me *New York Times*?

19 PË. Ka qenë dikun, një herë po e kam pa dikund, më ka thënë
20 dikush që e gjej. Ka qenë dikund. Ka qenë në gazetë. Po për
21 momentin nuk e kam, mirëpo është dikund në gazetë, gjindet
22 ajo, ai material. Në *Kohën Ditore* a ku ka qenë.

23 PY. Thatë në intervistën me ZPS-në, që dhe ky takim ka qenë
24 rreth gushtit, gjatë ofensivës serbe, kështu?

25 PË. Mund edhe mbas gushtit, mbas gushtit është kjo. Ka qenë

1 ofensivë. Po, kanë qenë luftime shumë. Kemi qenë në krizë në
2 atë kohë. Po.

3 PY. Dëshmitar, flasim për një temë tjetër. Ju këmbëngulni në
4 dëshminë tuaj dhe thoni që UÇK-ja ka qenë shumë e organizuar
5 dhe ka pasur zinxhirin komandues ushtarak, kështu?

6 PË. Ju lutem, unë jam ka thanë nga batalioni deri te brigada.
7 Ma andej nuk them. Se nuk kam njohuri. S'kam të drejtë unë me
8 thënë.

9 PY. Po ju si e zbatuat rregulloren e disiplinës në batalionin
10 tuaj, disiplinës ushtarake?

11 PË. Si, si e zbatum? Unë i kam raportu për çdo ditë i kam
12 raportu brigadës për punët që janë bë. Edhe një herë në javë
13 kam shku në mbledhje. Nuk e di çka kërkon tjetër. Domethënë,
14 për çdo ditë i kam raportu për punën që e kam bë. Plus kam
15 shku një herë në javë në mbledhje të brigadës. Si është
16 ndryshe?

17 PY. Po bëj një pyetje tjetër në fakt. E zëmë se një ushtar në
18 batalionin tuaj përleshet me një ushtar tjetër po brenda
19 batalionit.

20 PË. Po.

21 PY. Çfarë mase disiplinore do merrje për këta ushtarë, si do
22 t'i disiplinuje këta ushtarë?

23 PË. Besoj që keni qenë ma herët këtu në sallë kur u fol më
24 herët që qët punë e ka pas policia ushtarake. Unë jam kanë me
25 operativ. As që jam marrë me këtë punë. Këtë punë ka qenë

1 brenda brigadës ka qenë komandant i brigadës që i ka pas
2 policët e batalionit nën kontroll edhe ajo është marrë me atë
3 punë. Jo na, që kemi qenë operativë.

4 Ma herët u fol kur Prokurorja më pyeti për qeto gjena dhe
5 i ke në material aty lexoje. Është, domethënë, këtë punë është
6 marrë policia ushtarake, e cila polici ka qenë nën komandën e
7 brigadës. Unë jam nën betim, i nderuar, jam nën betim. Por
8 edhe kur jam nis knejna, ushtarët e batalionit më kanë
9 përcjellë dhe më kanë thënë "të lutem thuaj të vërtetën edhe
10 mbroje luftën se duke e thënë të vërtetën e mbron luftën e
11 drejt të UÇK-së" edhe këtë me plot përgjegjësi jam tuj tu
12 përgjigj.

13 Edhe një herë, kjo ka qenë rregullat për q'ato ça më
14 pyete, kur ka pas një problem a diçka janë ka policia
15 ushtarake, e cila ka qenë nën komandën e komandantit nën
16 brigadë. E kuptove?

17 PY. Pra, dëshmia jua --

18 PË. Po.

19 PY. -- kjo --

20 PË. Po.

21 PY. -- që ju si komandant batalioni nuk kishit kompetencë të
22 zbatimit masat disiplinore brenda batalionit tuaj, kështu?

23 PË. Jo. Jo. Asnjëherë.

24 PY. Dhe kur thoni se UÇK-ja ka qenë e organizuar, ju këtë e
25 thoni se kur keni hyrë në Kosovë në 1998, ju dhanë para për të

1 udhëtuar Jashar Saliu, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe ju dhanë edhe të mira të tjera logjistike, kështu?

4 PË. Jo, i kena marrë në -- Jashar Saliu na i ka dhënë paret
5 në Zvicër për rrugë. Ndërsa kur kemi ardhë në Tiranë i kemi -
6 është e shkume atje shumë mirë - në Tiranë Azem Syla na i ka
7 dhënë uniformat dhe ka ardhë me neve deri në Krumë. Në Krumë i
8 kemi marrë armatimin. Kemi hy mbrenda në mënyrë shumë të
9 organizume. Kështu kam thënë.

10 PY. Çfarë stërvitje bëtë përpara se të -- kur themi stërvitje
11 çfarë stërvitje ushtarake keni bërë?

12 PË. Stërvitje. Po më duket dhe kjo pyetje qesharake që ma
13 bën, po stërvitje për kondicion, praktiko-fizike, më shumë për
14 kondicionale.

15 PY. ZPS-së i keni thënë se stërvitja ushtarake që keni bërë
16 ju, ka qenë në Gjermani dhe keni luajt futboll, basketboll.

17 PË. Ajo është. Më fal që ju nguta të lutem. Më fal që u
18 nguta. Po ajo është kondicionalë, në qoftë se e kupton,
19 domethënë, për me pas kondicion, ke luajt futboll, ke lu
20 basketboll për me mbajt, ke gjuajt me pushkë ajrore dikund,
21 për me mbajt kondicionin. Kjo ishte. Unë e përfshina me një
22 fjalë, thashë përgatitje kondicionale.

23 PY. Pra, stërvitja juaj përpara se të hynit në Kosovë me UÇK-
24 në ishte, pra, stërvitja ishte të luanit basketboll, futboll
25 në mbrëmje në Gjermani, kështu?

- 1 PË. Po për shkak, me një anë i thuhet përgatitje
2 kondicionale. Po shumë e vërtetë. Ashtu kam thënë, ashtu
3 është.
- 4 PY. Në rregull. Në armatën jugosllave a keni qenë ndonjëherë
5 ushtar?
- 6 PË. Po.
- 7 PY. Kur jeni kyçur në armatën jugosllave çfarë stërvitje
8 ushtarake keni bërë?
- 9 PË. Atje kam qenë artiljeri e lehtë kundërajrore.
- 10 PY. Po. Po kur bëre shërbimin ushtarak të detyrueshëm bëre
11 stërvitjen, stërvitje bazë, apo jo?
- 12 PË. Po. Ku më ke kthy në 1993 -- 1983. I kam harru ato.
13 Ushtri sikur ju që e keni kry, se më duket ishe kroat. Sikur
14 ju që e keni shkollën -- ushtinë edhe unë ashtu e kam kry. Të
15 njëjtë. Si krejt bota. Si krejt njerëzit.
- 16 PY. Por e kupton çfarë është stërvitja bazë, apo jo?
- 17 PË. Si se kuptoj.
- 18 PY. Dhe UÇK-ja nuk ju bëri stërvitje bazë përpara se të hynit
19 në Kosovë, apo jo?
- 20 PË. Kena bë, po.
- 21 PY. Çfarë trajnimi, çfarë stërvitje bazë keni bërë? Çfarë
22 ishte kjo stërvitje bazë?
- 23 PË. Po të thashë unë me përdor armën, me qeto kondicionalet,
24 taktikat.
- 25 PY. Ku i keni bërë këto stërvitjet për taktikat, se nuk është

1 e reflektuar kjo në intervistën për ZPS-në?

2 PË. Në Shqipëri. Ku tjetër? Në Shqipëri. Kena --

3 PY. Ku? Ku në Shqipëri?

4 PË. Në Shqipëri.

5 PY. Ku në Shqipëri?

6 PË. Po para se më hy në luftë, kena ba te na edhe më herët

7 për me përdorë armën, shembull edhe në fshat tem ku jena kanun

8 aty në mal. Lexoj atje, i ke të gjitha, i kam thënë.

9 PY. "Para se të shkoje në fshatin tënd në luftë", e ke
10 fjalën për Krojmirin tani?

11 PË. Po.

12 PY. Unë po të pyes përpara se të hyje në Kosovë, pasi u
13 ktheve nga Gjermania, a ke bërë stërvitje bazë nga UÇK-ja,
14 UÇK-ja të dha të ofroi mundësinë për stërvitje bazë??

15 PË. Neve na kanë thënë derisa kemi hy mbrenda kemi stërvit.
16 Ju tregova , shembull, këtu te Kruma, aty në Krumë para se me
17 hy jemi përgatit fizikisht, përgatitje kondicionale, ju
18 tregova.

19 PY. Si jeni stërvit? Na e përshkruaj stërvitjen që keni bërë?

20 PË. Vrapim, vrapim, qysh me marrë pozitën, qeto.

21 PY. Kush e drejtonte këtë stërvitje?

22 PË. Ne jemi stërvit vetë si grup. Janë kanë dhe do persona
23 aty që s'i mbaj mend tash në Krumë. Kemi dal kemi gju atje
24 nalt, nuk e di dhe kush kanë qenë ata personat. Kemi gju në
25 kodër atje.

1 PY. Kur hytë në Kosovë, shkuat nga Likovci në Kleçkë dhe të
2 thanë që të krijoje një bazë në Krojmir, por nuk kishe ndonjë
3 emërim me shkrim, apo jo?

4 PË. Nuk kemi pas me shkrim, vetëm me gojë.

5 PY. Morët udhëzime nga Fatmir Limaj dhe ai të tha që të
6 shkoje në Krojmir dhe të krijoje një bazë të UÇK-së në zonën
7 tënde të përgjegjësisë, kështu?

8 PË. Është, na kur jemi ardhë nga Likovci, me tregu, unë shumë
9 i singertë më bë, kur kemi ardhë nga Likovci, Fatmiri veç e
10 kish pas bazën në Kleçkë. Edhe atëherë mu më kanë caktu qysh
11 atje nga Likovci për në Krojmir. Edhe atëherë i kam marrë
12 detyrat prej Fatmirit që me bë një thirrje atje me i afru
13 shokët, ushtarët, kush ka armë me na u bashkëngjit neve, me i
14 shkru emrat me ia pru që ushtarët, kaq ushtarë i kam. Emër,
15 mbiemrin, me i pru në Kleçkë. Dhe i tha kaq ushtarë, numrin e
16 ushtarëve, kën e ke për bë ushtarë. Edhe kështu ka fillu. Kjo
17 është fillimi. Domethënë, shumë e vërtetë. Edhe kemi vazhdu
18 kështu deri në fund.

19 PY. Pra, shkove në Krojmir --

20 PË. Po.

21 PY. -- dhe fillove të rekrutoje persona që ishin atje,
22 kështu?

23 PË. Po, I kam bë thirrje atje shokëve. Po.

24 PY. Dhe kështu fillove të formoje bazën e UÇK-së apo praninë
25 e UÇK-së në Krojmir, saktë?

1 PË. Po, normal.

2 PY. Personat që u kyçën e bënë këtë vullnetarisht, apo jo?

3 PË. Të gjithë vullnetarisht.

4 PY. Ti i pranove të gjithë ata që vinin?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe shpesh këta persona vinin me armët dhe me uniformat e
7 tyre, apo jo?

8 PË. Me armë. Uniformat ikën kep aty ka qenë një ku i kanë
9 kepun. Me armë të vetat kanë ardhun.

10 PY. ZPS-së i thatë dhe ata që kishin qenë me policinë serbe
11 deshën të kyçeshin, mund të kyçeshin, kështu?

12 PË. Jo, për aty nuk thashë që janë kyç. Po ata s'kanë ardhë.
13 Ata që kanë qenë me policinë serbe kanë ngelë me policinë
14 serbe nuk kanë ardhë te na.

15 PY. Thatë që brigada juaj ka pas edhe polici ushtarake,
16 kështu?

17 PË. Batalioni.

18 PY. Batalioni desha të thoja.

19 PË. Po.

20 PY. Dhe dëshmia juaj është që nuk ishin nën komandën tuaj por
21 të komandantit të brigadës, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe në dëshminë tuaj thoni që komandant brigade në atë
24 kohë ka qenë cili person?

25 PË. Në atë kohë ka qenë në fillim Fatmir Limaj. Në fund të

1 1998 ky ish-komandanti i policisë Haxhi Shala, u bë komandant
2 brigade, në fund të 1998.

3 PY. I keni thënë ZPS-së deri në gushtin e 1998, kur morët
4 vendimin ku u emëruat si komandant batalioni, nuk keni shkuar
5 në asnjë mbledhje në Kleçkë apo nuk dinit asgjë lidhur me
6 strukturat e tjera?

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të na jepni referencën?

8 DËSHMITARI: Nuk kam thënë.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na jepni
10 referencën për këtë?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Po mund të shikoni provën
12 materiale P1114.3. Dhe mund ta vendosim në ekran.

13 DËSHMITARI: Nuk kam thënë ashtu.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen 3692, rreshtat 7 deri
15 në 16.

16 PY. Është intervista që keni thënë për ish-Tribunalin e
17 Hagës, se mund të kem thënë ZPS-ja.

18 Është në shqip P1114.3, faqja 7, rreshtat 1 deri në 10.

19 DËSHMITARI: Nuk ka -- a të përgjigjem?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Presim që të vendoset, të dali
21 dokumenti në ekran.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ju
23 propozoja qëta riformulonit pyetjen dhe të thoni që ia ka
24 thënë TPNJ-së dhe jo ZPS-së.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është sqaruar kjo pikë në

1 Shënimin Përgatitor numër 1.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] E kuptoj që ka ndërruar dëshminë e
3 tij, po unë dua të shikoj dëshminë e tij origjinale.

4 PY. Që të korrigjojmë procesverbalin është dëshmia që keni
5 dhënë për TPNJ-në, pra, ish-Tribunalin e Hagës. Keni dhënë
6 dëshmi atje nën betim. Dhe unë po ju tregoj një faqe konkrete
7 lidhur me pyetjet dhe përgjigjet tuaja.

8 Fillon në rreshtin 7 në anglisht. Në rreshtin 7 pra në
9 anglisht edhe në 7 në shqip. Jo, rreshti 1 në shqip, thuhet:

10 "Unë ju kam thënë më herët që deri në ofensivat, aty nga
11 fundi i majit, njësi ka qenë Shukri Buja, ndërsa unë kam qenë
12 zëvendësi i tij, dyshi. Pas ofensivës është formuar batalioni,
13 brigada dhe unë kam marrë vendimin, vendimin që kam sjellë
14 këtu dhe në bazë të këtij vendimi u emërova komandant
15 batalioni. Për periudhën përpara kësaj, unë shumë rrallë kam
16 shkuar në Kleçkë dhe nuk mund ta di a ka pasur brigadë apo jo.
17 Këtë mund ta dijë Shukriu. Është më se e vërtet dhe prandaj e
18 kam sjellë dhe dokumentin që kam qenë, jam bërë komandant
19 batalioni pas ofensivës. Dhe që prej atëherë, domethënë, jam
20 bërë udhëheqës i shtabit në Krojmir".

21 E shihni këtë? Pra ju jeni emëruar në gusht?

22 PË. Unë me letër jam emëruar në gusht. Shumë e vërtet është
23 ajo. Ma herët, kam qenë më rrallë atje. Mirëpo, kjo,
24 domethënë, ka ekzistuar sikur kur ka qenë batalioni ashtu kemi
25 qenë. Organizimi ka qenë i njëjtë. Vetëm që nuk -- edhe më

1 herët se ka dokument kur edhe më herët është quajt batalion
2 edhe më herët. Për shkak, kam desht me qenë shumë i singertë
3 me tregu realitetin, se vërtet që më rrallë kam qenë në
4 mbledhje se ka shku Shukriu, i kam raportu Shukriut, Shukriu
5 ka raportu tek Fatmiri, kam qenë më rrallë. Edhe këtu e kam
6 thënë edhe tash e kam thënë që e kam përmirësu pak, po nuk e
7 kam përmirësu shumë, që kam shku më rrallë, se nuk kam ndryshu
8 diçka ndryshe.

9 Me letër ma kanë bë atëherë vendimin si komandant
10 batalioni. Po të njëjta struktura kanë qenë, të njëjta
11 struktura. Edhe numri ka qenë, domethënë, ka ekzistuar sikur kur
12 i kam marrë unë, sikur më herët. Edhe më herët kanë qenë
13 strukturat origjinale, domethënë edhe ma herët është raportu
14 në brigadë në Kleçkë. Sen nuk ka ndryshue si më herët, si më
15 vonë.

16 PY. Mua më intereson të di kur ke filluar të shkosh në
17 mbledhjet javore në komandën e Fatmir Limaj --

18 PË. Jo. Unë e kam --

19 PY. -- kur fillove të shkoje rregullisht?

20 PË. Unë kam shku më herët, domethënë, po, domethënë,
21 rregullisht që e kam pas tjetër përgjegjësi mbasi e kam marrë
22 letër, e kam marrun këtë vendimin për komandant batalioni, kam
23 pas përgjegjësi më shumë. Mirëpo edhe më herët kam shku edhe i
24 kam raportu Fatmiri, domethënë edhe Shukria edhe unë.
25 Shpeshherë kemi qenë bashkë në mbledhje. E kuptove?

1 PY. Jo tamam. Pyetja ime është kjo: kur fillove të shkoje çdo
2 javë në komandën e Fatmir Limaj?

3 PË. Çdo javë kam shku, domethënë, i rregull që kam pas
4 përgjegjësi, kam shku mbasi e kam marrë vendimin për komandant
5 batalioni prej Fatmirit. Ndërsa më herët kam shku më rrallë. E
6 thashë edhe ma herët. Se ka shku një Shukria, një herë unë,
7 domethënë, kemi shku ma rrallë. I kam raportu Shukrisë, s'kam
8 pas nevojë me shku unë atje. Këtu është puna. A mbasi e kam
9 marrë këtë vendim u dasht patjetër me shku një herë në javë.
10 Kam qenë i detyrum.

11 PY. Që ta kuptojmë të qartë dhe për procesverbal, kur thoni
12 pasi jam emëruar e ke fjalën pas gushtit të 1998? Pas 16
13 gushtit të 1998.

14 PË. Ju lutem, pasi jam emëruar me letër, domethënë, pasi më
15 ka ardhë vendimi. Unë më herët s'e kisha dit që u dasht me pas
16 një vendim. Unë edhe më herët i kam raportu si komandant
17 batalioni por vendim s'kam pasun. Jam tu thanë shumë
18 origjinal. Po.

19 PY. Dëshmitar, unë do të them si po e kuptoj unë dëshminë
20 tuaj dhe ju ose ma konfirmoni ose më korrigjoni. Pra, deri në
21 momentin që je emëruar në mes të gushtit të 1998, domethënë,
22 vetëm pas emërimit në mes të gushtit të 1998, ke filluar të
23 marrës pjesë rregullisht në takimet javore në komandën e
24 Fatmir Limaj, kështu?

25 PË. Po. Po edhe më herët kam marrë, po jo rregullisht sikur

- 1 tash, sikur tash mbasi që kam marrë vendimin. Edhe ma herët
2 kemi marrë. Veç që të mos merr tjetër kahje se, domethënë, në
3 rast se s'kam shku, ka shku Shukria.
- 4 PY. Po, e kuptoj. E kuptoj.
- 5 PË. Hierarkia ka qenë edhe më herët e njëjtë, s'ka pas ndo
6 farë ndryshimi.
- 7 PY. Haxhi Shala a merrte pjesë në të njëjtat mbledhje ku keni
8 marrë pjesë dhe ju n komandën e Fatmir Limajt?
- 9 PË. Ka marrë pjesë po jo që ka raportu ndonjë send, nuk është
10 përzi kur ishte polic.
- 11 PY. Po Nexhmi Krasniqi?
- 12 PË. Nganjëherë edhe ai ka --
- 13 PY. Ma merr mendja që edhe ai --
- 14 PË. Edhe ai ka marrë pjesë nganjëherë, po jo që ka raportu,
15 s'e kam ni asnjëherë tuj raportu.
- 16 PY. Unë po them, ky është hamendësimi im, që ata që ishin
17 pjesë të policisë ushtarake nuk -- pra, ju nuk keni qenë të
18 pranishëm kur ka pas anëtarë të policisë ushtarake dhe kur
19 raportnin ata, kështu?
- 20 PË. Jo, s'kam qenë kur kanë bë mbledhje ata me brigadën,
21 s'kam qenë.
- 22 PY. Vendimi për të emëruar si komandant batalioni, pra, në të
23 njëjtën kohë që ka dalë vendimi për t'ju emëruar ju si
24 komandant batalioni kanë filluar të krijohen dhe brigadat dhe
25 batalionet formale në zonën e Pashtrikut, kështu?

1 PË. Kanë qenë edhe ma herët, ju lutem.

2 PY. Po a njiheshin me emrin brigada? Kishin numra,
3 batalionet?

4 PË. Edhe ma herët, po edhe para se me marrë unë vendimin ka
5 qenë batalioni, kanë qenë brigadat. Po.

6 PY. Po e ndryshoni dëshminë. Po e ndryshoni atë që i keni
7 thënë TPNJ-së, pra, kështu?

8 PË. Çka kam ndryshu?

9 PË. Ua them unë edhe mund ta shohim dhe në ekran.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Është prova materiale P1114.3,
11 faqja 3713, në fillim të rreshtit 3. I njëjti dokument dhe në
12 shqip në faqen 29 dhe fillon në rreshtin 10.

13 PY. Fillojmë në rreshtin 10, Dëshmitar, kjo është përgjigja
14 që keni dhënë nën betim. Pyetja:

15 "Çfarë filloj të ndodhte në gusht me vendimin e gushtit,
16 më 16 gusht, ishte që kjo ushtri vullnetare në zona të
17 ndryshme të Kosovë duhej të organizohej, të zyrtarizohej në
18 një ushtri që i ngjante më shumë atyre ushtrive që gjendeshin
19 edhe në pjesën tjetër të Evropës. A më kuptoni se çfarë po
20 them?"

21 PË. Po, kjo --

22 PY. "PË. Po, po. Të kuptoj.

23 "PY. Dhe a e pranoni këtë?"

24 "PË. Pajtohem. Në atë kohë ka pasur shumë ndërkombëtarë
25 që kanë ardhë, kanë hy në bisedime, gjëra të tjera, por unë

1 kam qenë më i vogël, nuk jam takuar me ata, nuk kam marrë
2 pjesë në këto biseda".

3 A i qëndroni kësaj që i keni thënë TPNJ-së, pajtoheni me
4 këtë?

5 PË. A ta them kështu? Në këtë kohë është bë thuaja
6 ristrukturimi. Ristrukturimi është bën, domethënë, ka qenë një
7 ristrukturim. S'di sa e kuptoni ju ristrukturimi. Në këtë kohë
8 është bërë ristrukturim. Dhe shumë mirë e kam thënë këtu.
9 Domethënë, se në këtë kohë fillun me ardhë oficerë, u kyçshin
10 oficerë me shkollë e sende. E këtë kam desht me thënë unë.
11 Atëherë kanë fillu me ardhë dhe këta oficerët shqiptarë që
12 kanë qenë me shkollë të kryme edhe u bë një ristrukturim.
13 Është kërku me ju çu letër ma tepër, me bë renditjen ma
14 ndryshe. Kjo është.

15 PY. Okej. Erdhi ora e pushimit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
17 z. Misetic.

18 Dëshmitar, tani do bëjmë pushimin e drekës. Pushimi i
19 drekës zgjat deri në orën 2.30. Në 2.30 do të rifillojmë. Tani
20 mund të largoheni nga salla e gjyqit bashkë me Asistenten e
21 sallës. Ju lutem mos e diskutoni këtë çështje me askënd jashtë
22 kësaj salle.

23 DËSHMITARI: Ju thashë se jam i vetëm aty.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Rifillojmë në 2.30.

2 --- Pauza e drekës fillon në orën 14.30

3 --- Seanca rifillon në orën 14.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, para se të

6 vijë dëshmitari kam një çështje të shkurtër për të ngritur.

7 Tani kam edhe unë kufjet në kokë.

8 Para se të vijë dëshmitari është një çështje e shkurtër

9 që duhet ta diskutojmë në seancë private, ju lutem.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në

11 seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private,
5 të nderuar Gjykatës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim
7 një pushim dhjetë minutash në orën 3.30.

8 Në 43 faqet apo 45 faqet që ke, ku ke arritur deri tani?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Roberts ka shfrytëzuar i ka
10 shfrytëzuar mjaft prej tyre. Është 3.00 pa 25, kështu që besoj
11 që përpara pushimit të parë do të kenë përfunduar, përndryshe
12 pak më vonë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord. Z.

16 Dëshmitar, do të vazhdojmë me pyetjet që bën Mbrojtja e z.

17 Thaçi.

18 Misetic, ju e keni fjalën.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Pyetja ime e parë është, ka të bëjë

21 me strukturën e UÇK-së, çfarë formacionesh kanë ekzistuar në

22 nivelin poshtë batalionit në UÇK në rajonin tënd, pas 15

23 gushtit e kam fjalën?

24 PË. Batalioni, kompania, togu, skuadra.

25 PY. Pra, këto formacione kanë ekzistuar që nga kur? Kanë

1 ekzistuar edhe më përpara 15 gushtit?

2 PË. Po.

3 PY. Do të shohim një dokument që e keni diskutuar edhe me
4 Prokurorinë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Është prova materiale P8.

6 PY. Dëshmitar, kam nja dy pyetje lidhur me këtë dokument. Së
7 pari, titulli i këtij dokumenti është "Rregullore e Përkohshme
8 e Organizimit të Jetës së Brendshme të Ushtrisë". A ke dijeni
9 se përse këto rregulla kanë qenë të përkohshme?

10 PË. Vetë fjala tregon e përkohshme, ka mujt me ndryshu më
11 vonë. Për një kohë të caktume, sigurisht, ma merr mendja
12 është.

13 PY. Pra, sipas mendimit tënd, synimi ishte që këto të ishin
14 të përkohshme? Kështu e kupton ti?

15 PË. Mendoj ashtu. Kur vetë fjala thotë që e përkohshme.

16 PY. Në intervistën për ZPS-në keni dëshmuar se nuk keni pasur
17 dijeni sesi kanë funksionuar zonat e tjera, është e saktë?

18 PË. E saktë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër të
20 këtij dokumenti, ju lutem. Së pari titulli edhe titulli thotë
21 "Rregullore e Përkohshme".

22 PY. Në maj apo në qershor të vitit 1998, a e ke parë këtë
23 rregullore?

24 PË. Tash muj këtu mos me ka i saktë kur e kam marrë. Unë kam
25 mëndu që është në qatë kohë. Po, e kam pa.

1 PY. Të shohim pikën 2 ku bëhet fjalë për betimin ushtarak. Në
2 pikën 5, thuhet:

3 "Në kohën e caktuar, kur vjen një përfaqësues i një
4 komande eprore, komandanti i njësisë jep këtë komandë:
5 'Gatitu! Nderimi në qendër (majtas, djathtas) dhe raporton,
6 për nder armët!' Dhe pastaj ai raporton: 'Z. Gjeneral,
7 efektivi i kompanisë(I apo II) dhe komandant i kompanisë,
8 kolonel Çeliku'".

9 Shikohet aty. A e shikon?

10 PË. Po.

11 PY. Sipas mendimit tënd kush ishte kolonel Çeliku?

12 PË. Fatmir Limaj. S'e kam dëgju atëherë tuj i thënë kolonel
13 vetëm komandant Çeliku.

14 PY. Por a ke dijeni nëse ka patur ndonjë oficer tjetër të
15 UÇK-së i cili të ketë patur nofkën Çeliku?

16 PË. Jo.

17 PY. Kjo rregullore duket sikur është vetëm për zonën e Fatmir
18 Limajt, pasi këtu ka një dispozitë që ku bëhet fjalë për
19 nderimin e komandant apo kolonel Çelikut.

20 PË. Atëherë kurrë s'më ka shku mendja që e ka bë këtë Çeliku.
21 Na e kena pas këtë rregullore, ju thashë edhe më herët, se,
22 domethënë, deri në brigadë kemi dhënë kesi raportu ma lart jo.
23 Ka mujt me qenë edhe -- nuk kam dijeni. Nuk e di pse, pse
24 shkrun kështu.

25 PY. Po të ishte një rregullore për jetën e brendshme të

1 ushtrisë që do të zbatohet në të tërë territorin e Kosovës nuk
2 pritej që të ketë një betim me anë të cilit të nderohet
3 kolonel Çeliku, apo jo?

4 PË. Tash po e analizoj këtu, po e shof. Na e kena pas këtë
5 rregulloren. S'kam fjalë këtu. S'kam koment. S'besoj që ta
6 ketë bë Çeliku që e ka sjellë këtë vetë ai kokë më vete, po
7 mund edhe ta ketë sjellë. Kryesoren na e kemi marrë pi
8 brigadës.

9 PY. Atëherë shonim një dokument tjetër që të është treguar.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] P01121. Që është leja e
11 qarkullimit.

12 PY. A të kujtohet që e ke diskutuar këtë leje me Prokuroren
13 sot në mëngjes?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe thuhet që është lëshuar rreth datës 8 korrik 1998. E
16 shef datën?

17 PË. Po.

18 PY. A pajtohesh me mua se nuk identifikohet asnjë brigadë apo
19 batalion në pjesën lart majtas. Aty thuhet thjesht njësia
20 operative Çeliku.

21 PË. Nuk po shihet këtu. Vine pak më knej. Po. Po shifet.

22 PY. Më vjen keq. Aty thuhet: Ushtria Çlirimtare e Kosovës,
23 Njësiti Operativ 'Çeliku'". Je dakord?

24 PË. Po, shifet kjo. Normal që ë.

25 PY. Nuk ndonjë formacion si batalioni, brigada ose ndonjë gjë

1 të kësaj natyre, apo jo?

2 PË. Tek kjo leja nuk paska, mirëpo në këtë kohë ka pas
3 brigadë.

4 PY. Po të shohësh nën pjesën e nënshkrimit edhe komandantin
5 nuk e identifikon veten si komandant i ndonjë formacioni
6 ushtarak, thjesht i njësisë operative Çeliku, apo jo?

7 PË. Ashtu e paska bë ky.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim tani provën materiale
9 P9.

10 DËSHMITARI: A bën pse ma jep këtë? Pse ma bën këtë pyetje
11 tek kjo kur kjo nuk është e imja? Domethënë, kjo leje nuk
12 është e lëshuar nga unë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim]

14 PY. Unë po të pyes për shkak se i ke dhënë disa përgjigje
15 Prokurorisë dhe unë kam disa pyetje vijuese.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të vendosim provën
17 materiale P9 në ekran.

18 DËSHMITARI: Mirë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Ju janë bërë pyetje lidhur me këtë dokument, me
21 rregulloren e policisë ushtarake dhe po i tërheq vëmendjen e
22 pikës 4 ku thuhet që:

23 "Policia ushtarake është e varur nga Drejtoria e Policisë
24 Ushtarake ..."

25 Sipas mendimit tënd kur është krijuar drejtoria e

1 policisë ushtarake, nëse ke ndonjë dijeni?

2 PË. Nuk e di kur është formu drejtoria e policisë ushtarake,
3 se thashë më herët. ne e kemi njoft vetëm policinë ushtarake
4 të brigadës, jo më shumë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër, ju
6 lutem.

7 PY. Dhe të shohim pjesën ku janë nënshkrimet, në fund të
8 faqes në gjuhën shqipe, aty pretendohet se është i nënshkruar
9 nga shefi i policisë ushtarake, drejtoria e policisë ushtarake
10 Fatmir Limaj. A e shikon këtë pjesë? A ke dijeni se kur është
11 bërë drejtor i policisë ushtarake apo i drejtorisë së policisë
12 ushtarake Fatmir Limaj?

13 PË. Jo, s'kam dijeni.

14 PY. I keni thënë ZPS-së që ti e ke bërë përzgjedhjen e
15 anëtarëve të policisë ushtarake të batalionit tënd, a është e
16 saktë?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe unë po të them ty që Fatmir Limaj nuk është bërë
19 drejtor i drejtorisë së policisë ushtarake --

20 PË. Vetëm pak.

21 PY. Çfarë pyetje ke?

22 PË. Më herët. Unë e kam bërë përzgjedhjen, i kam çu emrat atje
23 edhe ata i kanë pranë. Kanë mujt edhe mos me pranë ndonjë
24 emër. Thonë "Ky s'bën", po prapë ata kanë vendosë.

25 PY. Kjo nuk ishte pyetja që kisha. Pyetja që kam unë është

1 apo propozimi që kam unë është që Fatmir Limaj nuk është bërë
2 drejtor i drejtorisë së policisë ushtarake të Kosovës deri në
3 nëntor të 1998. Pra, në kohën që ti ke përzgjedhur njerëzit që
4 të ishin anëtarë të policisë ushtarake në batalion, çfarë
5 rregullash duhet të ndiqnin ata?

6 PË. Në atë kohë ka qenë, ju lutem, në atë kohë ka qenë Haxhi
7 Shala komandant i policisë së brigadës dhe, domethënë, nuk ka
8 qenë -- Fatmiri ka qenë në atë kohë komandant brigade, ndërsa
9 Haxhi Shala ka qenë komandant i policisë ushtarake. Ai ka
10 vendos, jo Fatmiri.

11 PY. Pyetja që po bëj unë është e ndryshme.

12 PË. E ndryshme? Më fal.

13 PY. Si për policët ushtarakë që ke zgjedhur ti si e dinin ata
14 se cila do të ishte detyra që do të duhej të kryenin, si i
15 dinin ata çfarë detyrash do të kishin?

16 PË. I kanë marrë nga komandant i brigadës.

17 PY. Si në mënyrë kështu rastësore?

18 PË. Jo, re. Kanë mbajtur takime, sigurisht. Edhe pse unë s'kam
19 nevojë me i diskutu ato. Domethënë, s'janë për mua. Ata kanë
20 qenë më vete.

21 PY. Pra, ti i ke zgjedhur këta persona por më pas nuk ke
22 patur ide fare se çfarë --

23 PË. Jo.

24 PY. -- detyrash kanë patur për të kryer ata?

25 PY. Pra, atëherë çfarë kriteresh --

1 PË. Saktë.

2 PY. -- ke zgjedhur ti për t'i përzgjedhur? Si e dije ti se
3 çfarë kriteresh duhet të përmbushin këto persona të cilët t'i
4 po i përzgjidhje për të kryer detyra të për të cilat ti prapë
5 nuk kishe ide?

6 PË. Ju lutem, na i kemi propozu. Domethënë, ky, këtë, krejt
7 emrat dhe këta mujni me i marrë. Kena mëndu që janë djem ma të
8 mirë, ma të urtë, ma të sjellshëm. Ia kemi dhënë dhe s'kemi
9 pas nevojë na për ata me u marrë me këtë punë më. Kanë qenë
10 detyrat e ndame, shembull, u dashtë me u marr me operativë
11 atje, jo me policinë. Vetëm i kemi propozu edhe asgjë tjetër.
12 S'ka qenë, s'jam marrë me ta me atë punë.

13 PY. Kur ta tregojë këtë dokument Prokurorja në mëngjes, ajo
14 të pyeti nëse detyrat që përshkruheshin këtu ishin në
15 përputhje me ato që kanë bërë policia ushtarake. Dhe atëherë
16 mbi ç'bazë e dhe këtë përgjigje në mëngjes? Pse the që këto
17 detyra që përshkruan këtu janë në përshtatje me detyrat e
18 policisë ushtarake kur tani po thua që ti nuk ke pasur dijeni
19 se cilat kanë qenë detyrat e policisë ushtarake?

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kundërshtoj. Pasi kjo është në
21 kundërshtim me dëshminë e dhënë.

22 DËSHMITARI: Si, si edhe një herë?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni.

24 Përgjigju pyetjes.

25 Z. MISETIÇ: [Përkthim]

1 PY. I thatë Prokurores se jeni dakord që ky dokument pasqyron
2 detyrat e policisë ushtarake. Ndërkohë që tani duke ju
3 përgjigjur pyetjeve të mia po thua se nuk kishe ide se çfarë -
4 -

5 PË. Më fal.

6 PY. -- detyrash kishin ato, pasi kjo ishte çështje që ishte
7 në nivelin e brigadës?

8 PË. Tjetër dokument ka qenë këtu. Nuk ka qenë ky dokument. Ka
9 qenë një dokument tjetër, ku me sa di unë, kur kishin mbajt
10 mbledhje, kishin mbajt komandant i policisë edhe për atë
11 dokument kam thënë që i takojnë policisë, jo për këtë. Edhe
12 mund të ndodhë që nuk jemi tu u kuptu.

13 Unë them se detyrat, ia kam propozu të thashë personat
14 edhe ata tani janë marrë me ato punë, unë jo. Këtë nuk e di sa
15 jam i kuptueshëm. Ndërsa më herët Prokurorja e ka dhënë një
16 dokument tjetër. Ka qenë një dokument kur ka mbajt mbledhje
17 komandanti i policisë në batalionin e Tretë. Më duket ai
18 dokument është.

19 [Mbrojtja këshillohet]

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, ky është dokumenti që është treguar gjatë
22 mëngjesit.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Unë i kam treguar detyrat nga
24 kapitulli 8 i P8.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Atëhere të vendosim atë në

1 ekran. P8.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ishte në faqen 15 të këtij
3 versioni. U000-963, po. Për Sekretarinë është faqja
4 pararendëse.

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. A të kujtohet ta kesh parë këtë dokument gjatë seancës së
7 mëngjesit?

8 PË. Këtë e kam pa, po.

9 PY. A ishin këto detyrat që duhet të kryente policia
10 ushtarake në verën e vitit 1998?

11 PË. Po këto kanë mujt me qenë derisa unë nuk kam qenë në
12 polici, po këto kanë mujt me qenë. Unë s'e kam lexu,
13 domethënë, unë s'kam qenë në polici po këto kanë mujt me qenë,
14 se në bazë të disa çka thuhet këtu këto detyra i kanë pas
15 policia, shembull, detyrat u kryen me përgjegjësi të lartë.

16 Po. Po, po më kujtohet. Kjo është. Po saktë.

17 PY. Pra, ti thua që ti vetë nuk ke dijeni personale por
18 supozon që këto kanë qenë detyra që kanë kryer?

19 PË. Po.

20 PY. Përpara se ta tregonte Prokuroria a e kishit parë këtë
21 dokument më përpara?

22 PË. Kjo veç në qoftë se është këtu në këtë rregulloren a ku
23 është, se është shku, kohë e gjatë ka shku, ma s'i kam prek
24 këto që 25 vite. Mundet me qenë kjo në rregullore, sigurisht,
25 në rregullore të përkohshme të UÇK-së?

- 1 PY. Po, aty është.
- 2 PË. Mirë. Mirë.
- 3 PY. Po aty është. Aty është.
- 4 PË. Ashtu thashë mund të jetë aty thashë.
- 5 PY. Pyetja ime është a të kujtohet ta kesh parë këtë dokument
6 përpara se ta tregonte Prokuroria. A është përgjigja jote që
7 "po" i ke parë?
- 8 PË. Ju lutem, unë këtë rregulloren atëherë ia kam pru.
